

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 14 / verë 2018

Editorial 2

Gëzim Spahija

**Të Ndërtojmë Marrëdhënie
me Komunitetin** 3

Joseph B. Fuiten

**Kishat e Vogla Mund të
Shërbejnë më Mirë: Si të
Përfitoni nga Madhësia e
Kishës suaj** 8

Stephen Lim

**Si të Bini në Dashuri me
Kishën Tuaj** 14

Neil B. Wiseman

**Duke u Rritur Atëherë Kur
Askush Nuk po Ju Sheh** 22

Marcia Lednicky

**Menaxhimi i Konfliktit në
Kishat më të Vogla** 28


James D. Wilkins

Shërbesa me Dy Profesione: 32

**Strategji Legjitime apo
Një e Keqe e Domosdoshme**

Chris Rainey

“Ai Foli, dhe Gjëja u Bë.” 35
Psalmi 33:9



*Tema: Shërbesa në Bashkësinë e Vogël: Ushqyerja për
Shëndet dhe Rritje*



Tema: Shërbesa në Bashkësinë e Vogël: Ushqyerja për Shëndet dhe Rritje

Bashkësia lokale luan rolin thelbësor të kujdesit dhe të rritjes së shërbesës sonë frymërore. Në punën e saj përfshihet ungjillëzimi, shërbesat në kishë, grupet e vogla, lutja, këshillimi frymëror, trajnimet dhe seminarët e ndryshme si dhe projektet për t'u ardhur në ndihmë të tjerëve në formën e vizitave në shtëpi dhe mbështetjes së të varfërve.

Një nga mënyrat më efektive për rritjen frymërore të besimtarëve janë grupet e vogla, të cilat mbli-dhen rregullisht së bashku për të studiuar Biblën, për t'u lutur dhe për të inkurajuar njëri-tjetrin. Pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme të bashkësive lokale si kampe verore për fëmijë, adoleshentë dhe të rritur, studime biblike, fushata ungjillëzuese, apo vizitat në familje ose në spitale për të sëmurët, shoqëruar me lutje dhe ungjillëzim, e ndërtojnë kishën.

Shërbesa në bashkësinë e vogël, kishën tonë lokale, është kundra e përgatitjes dhe e rritjes së çdo anëtarit për të pasur një jetë të shëndetshme frymërore.

Njerëzit sot nuk janë të interesuar dhe nuk vijnë vetë drejt besimit, kështu që na duhet neve që të kalojmë pranë tyre, duke i treguar rrugën e drejtë e të bekuar të besimit. Në rast se dëshirojmë që ta fitojmë këtë botë për Krishtin, na duhet të ulemi në disa raste në vendet më të ulëta, ku ata janë, ku edhe na duhet të sakrifikojmë, duke dhënë shembullin praktik të gjërave të vogla të dashurisë së Perëndisë, pasi janë këto marrëdhënie që bëjnë që

Ungjilli të rrënjohet në zemrat e tyre, sepse **Jezusi tha: "Sepse, kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes të tyre"** (Mateu 18:20).

Çdo i krishterë në bashkësinë tonë të vogël nuk është thjesht një anëtar kishë, por është edhe një mbjellës, duke filluar së pari në shtëpinë e tij, në lagje, në punë e kudo që jeta t'i japë atij mundësinë për të mbjellë. Një kishë e fortë duket nga sa familje të forta ka. Një familje e fortë e bën edhe kishën të fortë.

Jezusi na la modelin e rritjes në bashkësinë e vogël dhe ishte pikërisht sipas këtij modeli që u rrit kisha e hershme. Ata ishin gjithmonë bashkë dhe ngulmonin me një mendje të vetme, në lutje dhe përgjërime, duke kërkuar mbushjen me Frymën e Shenjtë, duke qenë ngulmues në zbatimin e mësimet të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje, dhe shumë shenja e mrekulli i shoqëronin. Ata ishin duke lavdëruar Perëndinë dhe duke gëzuar simpatinë e gjithë popullit. Dhe Zoti i shtonte kishës çdo ditë ata që ishin shpëtuar.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv,
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve
të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 14
Verë 2018

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:

Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:

Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania

Cel: (+355) 69-406-8956

Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



TË NDËRTOJMË MARRËDHËNIE *me* komunitetin

Nga: JOSEPH B. FUITEN



**Dashuria për Perëndinë, të cilën e shprehim në kishë,
si edhe dashuria për njerëzit, duhet të rezultojnë në angazhime
dhe në marrëdhënie brenda komunitetit.**

"Sa është numri i pjesëmarrësve në kishën tuaj?"

Kjo pyetje më mërzit. Për të treguar qëndrimin tim negativ ndaj saj, gjithmonë përgjigjem në një mënyrë bishtnuese: "Varet se kur i numëron?".

Ndoshta jemi duke numëruar gjërat e gabuara në kishë, të cilat rezultojnë në një pikëpamje të shtrembëruar të suksesit në shërbesë. Duket sikur të gjithë janë të interesuar për numrin e të pranishmëve në shërbesën e të dielës në mëngjes, por pothuajse askush nuk është i interesuar për

numrin e farave që keni mbjellë. Pjesëmarrja apo numri i personave që vijnë të dielën në mëngjes nuk reflekton numrin e njerëzve të cilëve iu keni shërbyer atë javë. As nuk arrin që të masë se sa vetë do të vijnë te Krishti pas një viti nga dita e sotme. Pali tha që njëri mbjell, një tjetër ujit, por Perëndia i rrit (1 Korintasve 3:6). Dikush ka bërë një vëzhgim, duke thënë se kushdo mund të numërojë farat që janë në një mollë, por vetëm Perëndia mund të numërojë mollët që janë në një farë.



Kemi nevojë që të mendojmë rreth kishës në një mënyrë të re. Marrëdhënia jonë me Perëndinë nuk është krejtësisht private dhe personale. Ajo duhet të prodhojë fryt brenda kishës dhe brenda komunitetit. Dashuria për Perëndinë, të cilën e shprehim në kishë, si edhe dashuria për njerëzit, duhet të rezultojnë në angazhime dhe në marrëdhënie brenda komunitetit. Përpara se t'i fitojmë njerëzit për Jezusin, na duhet të ndërtojmë marrëdhënie të ngushta dhe të afërta me ta.

Na duhet mendësia e një mbjellësi farash. Në rast se duam të mbjellim fara, na duhet të dalim jashtë bunkerit tonë dhe të shkojmë në arë. Me qëllim që të ndërtojmë marrëdhënie cilësore në komunitet kërko-het të kemi vizionin e një mbjellësi farash për të ardhmen.

Në këtë analogji tonën të mbjelljes dhe të korrjes, komuniteti është vendi i mbjelljes. Janë disa arsye se përse shërbestarët duhet të zhvillojnë marrëdhënie pozitive në një komunitet. Së pari, marrëdhëniet janë një matës i rëndësishëm për kualifikimin tonë për shërbesë. Së dyti, komuniteti është vendi ku duhet të reflektojmë lehtësisht bindjen tonë ndaj urdhërimit të dytë më të madh. Së treti, komuniteti është vendi ku hyjmë në elementët e zakonshëm të jetës në kauzën tonë të përbashkët me shoqërinë. Dhe së fundi, zhvillimi i marrëdhënieve pozitive në komunitet mund të na ndihmojë që t'i mbushim me njerëz karriget e kishës të dielën në mëngjes. Le të marrim në konsideratë këto katër fusha.

MARRËDHËNIET - TË MASIM KUALIFIKIMIN TONË PËR SHËRBESË

Kur Pali i dha Timoteut tiparet e karakterit të pastorit të mirë ose të mbikëqyrësit, ai tha se pastori “duhet që të ketë dëshmi të mirë edhe ndër të jashtmit, që të mos bjerë në turp dhe grackën e djallit” (1 Tim. 3:7).

Dëshmia e mirë nuk është njësoj si mungesa e dëshmisë së keqe. Mund të jeni një person që nuk bën asgjë dhe të mos keni një dëshmi të keqe në

komunitet. Një dëshmi e mirë kërkon të keni ndërveprim pozitiv me të jashtmit. Për shkak të ungjillit, Pali pati shumë takime armiqësore me publikun. Por ai u shpëtua gjithashtu nga “aziarkët” (njerëz të jashtëm) të cilët ishin miqtë e tij (Vep. 19:31). Në më shumë se një rast, të jashtmit i shpëtuan jetën.

Pali e kuptoi rëndësinë që kishin miqtë në komunitet dhe kështu ai i bëri thirrje Timoteut që ta bënte dëshminë pozitive, një nga kushtet për personat që dëshironin të angazhoheshin në shërbesë. Një pyetje e mirë diagnostikuese është kjo: *Në qoftë se has në vështirësi, kush do të më vijë në ndihmë nga ky komunitet thjesht për faktin që iu pëlqej si njeri?*

Ja ku qëndron edhe ironia: Ne supozohet që t'i sjellim njerëzit te njohuria shpëtuese e Jezusit. Jezusi i shpëton ata në përjetësi përmes shërbesës sonë, por ata mund të na shpëtojnë neve në tokë nëpërmjet aftësive, njohurisë apo urtësisë së tyre. Përpara se të ndodhë e gjithë kjo dinamikë, na duhet që të ndërtojmë marrëdhënie të ngushta me ata që janë jashtë kishës.

TË DUAM KOMUNITETIN TONË

Kategoria e dytë më e gjerë e marrëdhënies në komunitet zhvillohet ndërkohë që përmbushim urdhërimin e dytë më të madh, pra, të duam të afërmin tonë porsì vetveten (Mateu 22:34-40). Kur tregojmë dashuri për njerëzit, atëherë zhvillojmë marrëdhënie të thella dhe afatgjata. Njerëzit në nevojë, që marrin ndihmë prej jush, nuk do ta harrojnë kurrë atë. Ndoshta samaritani i mirë pati një marrëdhënie të thellë dhe afatgjatë me një person të traumatizuar nga komuniteti.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, ka pasur një rritje të jashtëzakonshme të shërbesave të dashurisë që janë organizuar nga kishat dhe anëtarët e tyre. Kisha jonë ka qenë pjesë e kësaj lëvizjeje.

Para dy javësh mora një mesazh në postën elektronike nga një grua e cila ishte e dëshpëruar. Makina e saj ishte prishur dhe ajo nuk kishte para as që të

blinte një makinë tjetër dhe as të rregullonte atë që kishte. Pa një makinë, ajo nuk mund të shkonte dot në punë. Edhe pse shkonte në një kishë tjetër, më shkroi mua sepse e dinte që ne rregullonim makina në shërbesën tonë të servisit. Ne kemi katër mekanikë në kishën tonë dhe kemi vendosur një tarifë mbi bazën e të ardhurave të personit për t'i ndihmuar ata që nuk kanë mundësi ta çojnë makinën e tyre për ta rregulluar në ndonjë servis apo në ndonjë oficinë tjetër. Si përfundim, nuk e riparuam dot makinën e saj. Por ama, i shitëm asaj një makinë që ishte në gjendje të mirë pune dhe ia mbartëm ne shpenzimet e kredisë. Ashtu si samaritani që ia lidhi plagët burrit që ishte shtrirë anës rrugës, edhe ne ia lidhëm asaj plagët e automjetit dhe e lamë të vazhdonte punën. Kjo gjë ndërtoi marrëdhënie të mira me një familje të tërë.

Disa herë gjatë javës, njerëz nga komuniteti vijnë në kompleksin tonë dhe ndalen në shtëpinë e shërbesës. Ata vizitojnë bankën e ushqimit e cila është e furnizuar me ushqime të freskëta dhe ushqime të paketuara. Gjithashtu mund të zgjedhin mes rrobave cilësore të reja apo të përdorura, të ekspozuara në mënyrë të bukur tek banka e veshjeve. Ndërsa banka e mobiljeve përmbush nevojat shtëpiake. Shumë kisha kanë zbuluar se këto shërbesa janë mënyra të shkëlqyera për të ndërtuar marrëdhënie me njerëzit e komunitetit. Dhurata, dhuruesi dhe marrësi janë të gjithë të lidhur së bashku në një marrëdhënie pozitive.

Këto vepra rrjedhin nga besimi ynë se të duash të afërmin kërkon vepra të prekshme. Dashuria që nuk shfaqet nuk është fare dashuri. Ky lloj aktiviteti nuk është fakultativ për ungjillin apo për të krishterët.

Edhe jo të krishterët e kuptojnë se krishterimi përfshin dashurinë. Kur gjejmë mënyra për t'i bekuar, edhe atëherë kur paguajnë një pjesë të kostos, ata e kuptojnë dashurinë që iu tregohet. Përmes këtyre veprave të dashurisë, ne po fitojmë të drejtën për t'u dëgjuar. Nuk kemi frikë ta fillojmë bisedën me fjalë që janë një dëshmi e mirë për ungjillin. Kemi zbuluar se këto fjalë dëshmuuese marrin një reagim miqësor kur zemra është përgatitur më parë nga një *vepër dashurie* e dëshmisë së mirë.

Jezusi dha si mësim se jetesa me drejtësi kërkon dhënien e lëmoshës si edhe lutje dhe agjërim (Mateu 6:3, 4). Një shërbestar është i kualifikuar vetëm atëherë kur ai apo ajo ka një marrëdhënie pozitive me të jashtmit. Po ashtu, një i krishterë vepron në një mënyrë të krishterë vetëm atëherë kur ai shfaq dashuri për dikë përmes një veprë mirësie apo lëmoshe. Ne duhet t'i duam njerëzit në një mënyrë të prekshme sepse këtë na e kërkon ungjilli. Gjithashtu sepse jemi duke ndërtuar marrëdhënie dhe duke mbjellë fara të gjalla në jetët e njerëzve që janë në

komunitetin tonë. Këto vepra dashurie nuk i kryejmë me qëllimin parësor për të fituar marrëdhënie, por ato janë një rezultat i pashmangshëm.

Ndonjëherë pastorët shqetësohen se do të “mbeten thatë” në rast se ndihmojnë të tjerët. Në fakt, e kundërta ndodh. Kur njerëzit shohin se jeni duke ndihmuar në mënyrë altruiste dikë tjetër, edhe ata do të duan të përfshihen. Bujaria frymëzon të dhënit, ndërsa grumbullimi i rezervave i mbyll rrugën furnizimit. Jezusi tha: “Jepni dhe do t’ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese do t’ju jepet në prehër, sepse me atë masë që do të matni, do t’ju matet edhe juve përsëri” (Luka 6:38). Plotësimi i nevojave të vërteta të njerëzve përmbush urdhërimin e dytë, pra, që të duam të afërmin tonë. Kjo gjithashtu kalon edhe tek një nga ligjet e mëdha të Perëndisë për furnizimin. Në veçanti, kjo ka të bëjë me ndihmën që ne iu japim atyre që janë në nevojë.

DUKE PËRDORUR ELEMENTËT E ZAKONSHËM TË JETËS

Kategoria e tretë e marrëdhënies në komunitet zhvillohet ndërkohë që hyjmë në elementët e zakonshëm të jetës. Me fjalë të tjera, duke e jetuar jetën si çdokush tjetër.

Jezusi mori pjesë në një dasmë dhe iu bashkua festimeve. Ndoshta ishte i ftuar për shkak se ishte mik i çiftit që po martohej. Jezusi po jetonte një jetë të zakonshme dhe po merrte pjesë në një aktivitet të zakonshëm. Por kjo ngjarje normale i ofroi Jezusit një mundësi për mrekullinë e tij të parë.

Kur bëhemi të krishterë, ne nuk rrëmbelemi menjëherë. Por jetojmë në këtë planet bashkë me detyrat dhe gëzimet e zakonshme që vijnë për të gjithë njerëzit. Shkojmë në punë. Ushtrohemi në sporte. Bëjmë fëmijë dhe përfshihemi në aktivitetet e tyre. Unë jam i krishterë, por gjithashtu jam edhe një qytetar. Kur e kombinojmë krishterimin dhe komunitetin, zbulojmë se qyteti i Perëndisë ka një kauzë të përbashkët me qytetin e njeriut. Mundësitë më të mira që kemi si shërbestarë mund të na vijnë për shkak se jemi duke jetuar një jetë normale dhe duke marrë pjesë në aktivitete normale.

Që prej kohës së gjimnazit kam qenë i dhënë pas politikës. Por edhe kur u bëra pastor, nuk hoqa dorë nga përkatësia ime politike. Puna ime jashtë kishës në organizata politike ka qenë pjesë e të qenit një qytetar i mirë, dhe gjithashtu është kthyer në një thesar të mbushur me kontakte dhe marrëdhënie. Shpeshherë më kërkojnë të lutem gjatë seancave të zakonshme të legjislaturës. Unë nuk pretendoj të kem zbuluesë hyjnore për çdo qëndrim politik që mbaj. Thjesht përpiqem të jetoj në praktikë pjesët thelbësore të Biblës dhe i lejoj ato të formojnë mendimet e mia politike dhe qytetare.

TË NDËRTOJMË URA DREJT KOMUNITETIT TONË

Para dy vitesh nisa një marrëdhënie miqësore me drejtorin e shërbimit zjarrfikës të qytetit tonë. Përmes kësaj marrëdhënieje, zbuluam mënyra të reja për të ndërtuar ura drejt komunitetit tonë. Qyteti ynë ka çdo vit një festë për të përkujtuar themelimin e tij. Ne aplikuam për të pasur një kioskë në festën e qytetit dhe aplikimi ynë u miratua. Kioska kishte një parullë të madhe në të cilën lexohej: "Testoni koeficientin tuaj të inteligjencës frymërore. Përgjigjuni ndaj pyetjeve tona rrufe dhe fitoni një dhuratë falas". Ne kishim zhvilluar një

provim të shpejtë me pyetje rrufe duke përdorur Rugën Romake drejt Shpëtimit dhe trajnuam punëtorët si ta përdornin provimin si një mjet për të dëshmuar. Blemë gjithashtu disa bidona me ujë me etiketa të shtypura me emrin dhe logon e kishës sonë. Uji ishte dhurata falas për njerëzit që do të fitonin. Në bazë të numrit të provimeve që u dorëzuan, si dhe të sasisë së ujit që dhuruam, patëm të paktën 350 bashkëbisedime tek e tek me njerëzit në lidhje me ungjillin. Rezultatet e sakta të diçkaje të tillë janë të vështira për t'u llogaritur.

Askush nuk u shpëtua gjatë atij evenimenti, dhe vetëm 15 njerëz e vizituan kishën tonë të dielën pasuese si rezultat i atij ungjillëzimi një ditor. Por ungjilli iu prezantua disa qindra njerëzve, dhe 25 anëtarë nga kisha jonë fituan një përvojë të vlefshme për të dhënë dëshmi. Këto dyer të hapura erdhën si rrjedhojë e marrëdhënieve që kishim ndërtuar me komunitetin.

JOHN SIMS, pastor në Cedar Park në qytetin Northshore, Uashington

(Rruga Romake drejt Shpëtimit mund të gjendet në internet)

Ndonjëherë miqtë e mi që janë të përfshirë në politikë më ofrojnë perspektiva të cilat nuk mund t'i gjeja askund tjetër. Marrëdhëniet e ngushta që kam ndërtuar me politikanë kanë siguruar mundësi për të ndarë ungjillin. Për shkak se jam i përfshirë me ta, edhe ata janë të gatshëm të jenë të përfshirë me mua. Madje edhe politikanët që nuk janë të krishterë më kanë bërë pyetje. Unë isha në territorin e tyre prandaj ata u ndjenë rehat për të hedhur hapin e radhës në ndërtimin e marrëdhënieve. Unë jam lutur për disa politikanë dhe i kam drejtuar ata në pranimin e Krishtit si Shpëtimtar. Këto mundësi nuk do të kishin ardhur kurrë nëse nuk do të kisha qenë një qytetar i zakonshëm i cili përpiqet të bëjë detyrën e tij për vendin e tij.

Shumë pastorë kanë zbuluar se grupet e shërbimit në komunitet janë grupe pjellore për të takuar njerëz. Ndonjëherë njerëzit kanë nevojë vetëm për një marrëdhënie me një pastor që të fillojnë të vijnë rregullisht në kishë. Në shumë raste mund ta filloni me një miqësi, e cila ju çon në një diskutim që më vonë rezultoi në ardhjen e tyre në kishë. Mbjellësi i farave e kupton që mbjellja dhe korrja nuk mund të ndodhin brenda të njëjtës ditë.

Unë kam ndërtuar marrëdhënie me pastorë dhe me kisha në zonën tonë. Me kalimin e kohës, këto marrëdhënie sjellin kthesa befasuese në jetët tona. Në dy raste, disa kisha të pavarura në zonën tonë po hasnin vështirësi. Atyre iu mungonte forca që vjen nga të qenit pjesë e një denominacioni. Për shkak se unë kisha ndërtuar marrëdhënie me disa prej udhëheqësve të tyre, ata më ftuan që të ndihmoja për të ndërmjetësuar dhe për të zgjidhur problemet. Po të kisha qëndruar i mbyllur brenda katër mureve të kishës sonë, këto mundësi nuk do të kishin ardhur kurrë.

KORRJA E FARAVE

Përgjatë viteve, marrëdhëniet e ndërtuara me komunitetin e kanë ndihmuar kishën tonë që të rritet. Shumë prej farave që kemi mbjellë, janë korrur nga kisha dhe tani përbëjnë numrin e të pranishmëve të dielën në mëngjes. Nga ana tjetër, ka me mijëra njerëz në zonën tonë të cilët momentalisht nuk kanë një marrëdhënie me ne përmes shërbesës së adhurimit. Ata e kanë një marrëdhënie me ne, por jo një marrëdhënie adhurimi. Megjithatë, jam i sigurt se farat e shumta që janë mbjellë, do të prodhojnë të korra. Farat e mia mund të shfaqen në adhurim. Ato mund të kthehen në një bekim dhe dëshmi për mbretërinë e Perëndisë. Ato mund të jenë të pranishme në adhurimin e një kishe tjetër. Për mua kjo gjë nuk është problem.

Unë nuk jam thirrur për të ndërtuar kishën më të madhe me pjesëmarrjen më të lartë gjatë të dielës në mëngjes. Por jam thirrur për të mbjellë farën e ungjillit përmes predikimit, jetesës dhe marrëdhënieve të mia. Ne kemi një kishë të fortë me shumë shërbesa efikase. Vetëm Perëndia e di potencialin e ardhshëm për korrjen e farave të marrëdhënieve që ne po mbjellim sot.




JOSEPH B. FUTEN, D.Min., është pastori kryesor i Asambleve të Perëndisë të Cedar Park në qytetin Bothell, Uashington.

Kishat e vogla mund të shërbejnë më mirë Si të përfitoni nga madhësia e kishës suaj

Nga: **STEPHEN LIM**



*Një përqindje e madhe e punëtorëve
profesionistë të krishterë, përfshirë këtu gati
rreth 80 për qind të misionarëve të huaj,
vijnë nga kisha të vogla.*



“Duke marrë parasysh pothuajse të gjithë faktorët e konsiderueshëm të cilësisë, kishat më të mëdha janë të pafavorizuara në krahasim me kishat më të vogla”.¹ Ky ishte përfundimi befasues në të cilin doli Kristian Shvarc (Christian Schwarz) pas studimit më gjithëpërfshirës rreth rritjes së kishës që është kryer ndonjëherë, i cili mbulon mbi një mijë kisha në gjashtë kontinente. Hulumtimi dhe vëzhgimet e të tjerëve, së bashku me përvojën time, e konfirmojnë vlefshmërinë e studimit.

Pavarësisht se ka më pak njerëz, staf më të vogël, më pak ndërtesa, burime dhe programe, një kishë e zakonshme e vogël prodhon:


- miqësi më të mira.
- kujdes më të mirë pastoral.
- dishepullizim më të mirë.
- përfshirje më të madhe në shërbesë.
- më shumë njerëz të thirrur në shërbim të krishterë.

përforcohet edhe nga fakti se mesatarisht rreth 46 për qind e anëtarëve të tyre janë pjesë e një grupi të vogël, krahasuar me vetëm 12 për qind në kishat e mëdha. Kishat më të mëdha përpiqen të krijojnë një atmosferë të kishave të vogla, gjë e cila është diçka që ekziston në mënyrë të natyrshme në shumicën e kishave më të vogla.

Kujdes më të mirë pastoral

Në një kishë të vogël, pastori e njeh secilin nga anëtarët nëpërmjet kohës që shpenzon me çdokënd prej tyre në aktivitete të ndryshme.

Në fillimet e shërbesës sime, kam punuar si pastor në një kishë të vogël në Los Anxhelos. Jo vetëm që u predikoj njerëzve, por gjithashtu punoja bashkë me ta nëpër komitete, vizitoja shtëpitë e tyre dhe lyeja dhe pastroja përkrah tyre përgjatë javës. Çdo javë transportoja me makinë nëpër aktivitete të rinj dhe fëmijë, dhe për çdo sezon luaja në skuadrat e bejsbollit dhe të basketbollit të cilat organizoheshin



Jo të gjitha kishat më të vogla po ecin mirë. Shumë prej tyre janë të shkurajura apo duke kaluar nëpër vështirësi. Disa janë të vendosura në komunitete me popullsi në rënie, ndërkohë që të tjerat rriten nga brenda ose janë të vetëkënaqura. Si të përballen pastorët e kishave më të vogla me këto realitete, dhe si të përfitojnë nga madhësia e kishave të tyre?

Qëllimi im në këtë artikull është që të inkurajoj pastorët e kishave më të vogla, duke u treguar se si madhësia e kishave të tyre mund të jetë një ndihmë, dhe jo pengesë, për efikasitetin në shërbesë.

DUKE E BËRË PUNËN MË MIRË

Më poshtë janë disa nga sferat në të cilat kishat më të vogla shpeshherë kryejnë shërbesa më të mira sesa ato më të mëdhatë.

Miqësi më të mira

Në marrëdhëniet e kishave më të vogla, shumë vetë kanë përmendur dinamikën e një familjeje, ku të gjithë njihen dhe ndihen të lidhur me njëri-tjetrin. Kjo

nga kisha. Arrita ta njihja plotësisht bashkësinë dhe shumë shpejt isha i vetëdijshëm për rastet kur dikush kishte ndonjë problem.

Pastorët e kishave të mëdha duhet të shpenzojnë më shumë kohë në administratë në mënyrë që programet e tyre të shumta të funksionojnë rrjedhshëm, dhe atyre u duhet shpeshherë të marrin rolin e një drejtori ekzekutiv. Ata mund të miqësohen vetëm me anëtarë të përzgjedhur. Ndërsa me të tjerët në bashkësinë e tyre, edhe në rast se kanë ndonjë njohje, e kanë të kufizuar atë.

Dishepullizim më të mirë

Përse bëjnë kaq pak ndryshim në shoqërinë tonë ata persona që shkojnë rregullisht në kishë? Dallas Uillërd (Willard) e gjykon mungesën e dishepullizimit të vërtetë një gjë kaq të dukshme sa që e quan këtë problem “elefanti në kishë”.²

Shumë shpesh e kemi marrë si të mirëqenë se njerëzit dishepullizohen për shkak se kanë përfunduar një kurs gjashtë mujor. Një pjesë e madhe e dishepullizimit ka të bëjë me kohën e shpenzuar

regullisht me njerëzit në mënyrë që ata të mësojnë nga cilësia e jetëve tona. Apostulli Pal shkroi: "Jini imitues të mi, ashtu si unë jam i Krishtit" (1 Korintasve 11:1). Kur jemi me njerëz, jemi në gjendje të vëzhgojmë progresin e tyre dhe t'u sigurojmë inkurajim dhe ndreqje. Gjithashtu, edhe lutja dhe kujdesi për progresin e tyre frymëror, i motivon ata që të rriten.

Dishepullizimi sjell përfitime të mëdha në shumëfishimin e vetes sonë përmes të tjerëve. Përveç shërbesës shëtitëse të Jezusit duke dhënë mësim dhe duke shëruar, Ai gjithashtu shpenzoi tri vite e gjysmë duke dishepullizuar një bashkësi prej 12 individësh. Këta dishepuj, të fuqizuar nga Fryma, filluan Kishën në mbarë botën me një të korrë të shtrirë në një periudhë 20 shekujsh. Zakonisht pastori duhet që të paktën të dishepullizojë plotësisht një grup fillestar përpara se grupi pastaj të dishepullizojë të tjerë. Këtu, pastori i kishës së vogël, me më pak programe për të mbikëqyrur, ka një avantazh të pastër në kohë.

Përfshirje më të madhe në shërbesë

Për shkak se zakonisht pastori në një kishë të vogël është i vetmi person me rrogë i stafit të kishës, anëtarët e dinë se në qoftë se ata nuk marrin pjesë në shërbesë, atëherë shërbesa nuk do të kryhet. Madje edhe të rinjtë janë të inkurajuar që të shërbejnë. Të gjithë ndihen të domosdoshëm. Gatishmëria për të mësuar "në rrugë e sipër" merr një rëndësi më të madhe sesa profesionalizmi që pritet në kishat më të mëdha. Në kishat e vogla, rreth 31 për qind e anëtarëve shërbejnë në një shërbesë që përputhet me dhuntitë e tyre, ndërkohë që në kishat shumë të mëdha shërbejnë vetëm 17 për qind e anëtarëve.

Kur fillova punën si pastor në kishën në Los Anxheles, përveç fëmijëve, bashkësia ishte e përbërë nga dy të rritur, dhjetë studentë dhe dhjetë gjimnazistë. Pa asnjë përjashtim, secili prej tyre u përfshi shumë shpejt në shërbesë.

Më shumë reagim ndaj shërbimit të krishterë

Vëllai im, meqenëse sapo ishte diplomuar nga një kolegji biblik, filloi të punonte si pastor në një kishë të hapur së fundmi në San Françisko. Gjatë tri viteve të para, tre adoleshentë ndjenë thirrjen e Perëndisë për t'u përfshirë në shërbesë. Njëra prej tyre, bashkë me bashkëshortin e saj, më vonë shkoi në një ishull të largët e të paungjillëzuar në Filipine, ku ata ndihmuan me qindra vetë të bëheshin besimtarë; një tjetër u bë pastor; ndërsa i treti shërben me stafin pedagogjik të një kolegji biblik.

Ky rezultat pajtohet me vëzhgimet e Ron Klassen dhe John Koessler, të cilët janë ekspertë për kishat e vogla: "Një përqindje jo e barabartë e punëtorëve profesionistë të krishterë, duke përfshirë këtu gati rreth 80 për qind të misionarëve të huaj, vijnë nga kishat e vogla".³ Pse? Sigurisht për këtë rezultat kontribuojnë kujdesi pastoral personal i kishës së vogël, dishepullizimi dhe mundësia për t'u përfshirë në shërbesë.

QËNDRIMET QË NEVOJITEN

Janë tri qëndrime që i ndihmojnë kishat e vogla për t'i vënë në përdorim dinamikat e tyre unike.

Besoni se Perëndia mund t'ju përdorë.

Kini besim se Perëndia do ta bekojë shërbesën tuaj, dhe që kishat e vogla mund të bëjnë gjëra të mëdha për Perëndinë. Kjo e çliron Frymën që të veprojë në situatën tuaj.

Jini një shërbëtor besnik.

Perëndia nuk i gjykon pastorët nga numri i besimtarëve apo nga arritjet e tyre. Në fund të fundit, është ai që siguron dhuntitë, trajnimin dhe mundësitë. Përkundrazi, ai thërret secilin për t'i dhënë atij lavdi duke i shërbyer me besnikëri kudo ku zgjedh që të na vendosë (1 Korintasve 4:2). Jezusi u lut kështu: "Unë të kam përlëvduar mbi tokë, unë e kam kryer veprën që më ke dhënë të bëj" (Gjoni 17:4). Thirrja e Perëndisë duhet të ketë prioritet më shumë sesa reputacioni dhe karriera jonë.



Përjetoni vetëvlerësim si një fëmijë i dashur i Perëndisë.


Një pozitë e përlulur në shërbesë nuk na bën që të ndihemi të kënaqur kur e lejojmë atë të na sjellë ndjesi inferioriteti. Kështu, fillojmë e kërkojmë lëndina më të blerta, duke menduar, gabimisht, se kjo do të prodhojë tek ne një ndjesi më të madhe të vetëvlerësimit.

Në rininë time kam vuajtur nga vetëvlerësimi i ulët, të cilin e intensifikuan edhe më shumë rrethanat e mia të varfra si një pastor në Los Anxhelos. *Çfarë mendojnë për mua kolegët e mi në shërbesë? Po sikur të më shihnin në këto çaste shokët e fakultetit apo të seminarit biblik?* Kurdoherë që më vinin këto mendime, trupin ma pushtonin të dridhurat. Kaluan shumë vite përpara se të mësoja ta pranoja plotësisht identitetin tim në Krishtin, edhe pse nga ana

Përdorni ato që keni.

Si pastor i një kishe të vogël, ndonjëherë mendoja me vete: "Ah sikur të kisha fondet dhe pajisjet që ka X kishë. Imagjino programet që mund të bënim. Ah çfarë do të bëja po të kisha stafin dhe talentin e Y kishe!". Megjithatë, ne mund të përdorim vetëm ato që kemi, jo ato që do të donim të kishim. Lakmia sjell zhgënjim dhe acarim.

Burimet e pakta na detyrojnë të jemi më krijues. Kisha jonë në Los Anxhelos mbledhë në një shtëpi të rrënuar 80 vjeçare, ku gjithashtu banoja edhe unë për shkak të domosdoshmërisë financiare. Për shkollën e së dielës, pasi ishin mbushur të gjitha dhomat, përdornim oborrin e pasmë dhe oborrin para shtëpisë, garazhin dhe qilarin. Më pas, morëm hua për përdorim bodrumin e një fqinji. E prapëseprapë ishim plot e përplot. Për të dielat pasdite arritëm të



intelektuale isha shumë i ndërgjegjshëm për këtë. Kur e gjejmë vlerën tonë në identitetin që kemi në Krishtin, atëherë do të jemi më pak të shqetësuar se ku shërbejmë.

VEPRIMET QË NEVOJITEN

Kishat e vogla nuk e kryejnë shërbesën automatikisht më mirë. Bashkë me qëndrimet e duhura, pastorët kanë nevojë që të ndërmarrin hapa të përshtatshme për të rritur avantazhet e tyre.

Gjeni një "qoshe".

Në rast se i përhapim burimet tona të kufizuara dhe punonjësit tanë si vaji në lakra, nuk do të arrijmë gjë. Përkundrazi, zbuloni disa nevoja në komunitetin tuaj të cilat e kanë potencialin për t'u përmbushur nga anëtarët tuaj. Kur isha në Los Anxhelos, u përqedrova për të arritur fëmijët dhe të rinjtë që nuk shkonin në kishë, dhe punëtorët tanë të rinj shkëlqyen në këto shërbesa. Aty nga viti i pestë, në takimet tona vinin mesatarisht në javë rreth 100 fëmijë dhe 100 të rinj.

merrnim hua ambientet e një kishe që ishte 16 km më larg, dhe filluam një degë të shkollës të së dielës. Kjo rezultoi në më shumë fëmijë të arritur. Duke qenë se nuk kishim shumë të rritur si mësues, atëherë mobilizuam të rinjtë e kishës, të cilët treguan se ishin punëtorë të jashtëzakonshëm. Në qoftë se Perëndia na ka thirrur në një shërbesë, ai do të sigurojë ato që nevojiten.

Dishepullizoni dhe mentoroni disa persona kyçë.

Jezusi na tregoi urtësinë për të gjetur disa individë me potencial të madh (edhe pse dishepujt e tij nuk u dukën të tillë në fillim) dhe për të derdhur jetët tona tek ata. Vini re gjithashtu shërbesën e Barnabas me Palin dhe Markun, si dhe shërbesën e Palit me Timoteun dhe Silën. Pyesni veten: Cilët janë të rriturit ose të rinjtë të cilët Perëndia po më thërret t'i formoj nga ana frymërore? A është dikush që ka potencial udhëheqësi të cilin mund ta mentoroj?

Ngrini një rrjet.

Shpeshherë, pastorët e kishave të vogla ndihen të izoluar. Ata kanë nevojë të takohen me shërbestarë të tjerë për miqësi, mbështetje dhe informacion. Për çështje të tjera specifike, ata mund të telefonojnë për të marrë udhëheqje nga pastorë të cilët i respektojnë. Zakonisht këta pastorë janë goxha të gatshëm për të ndarë urtësinë e tyre me të tjerët. Nuk duhet ta lejojmë krenarinë, të qenit të pavarur apo të qenit të zënë që të na pengojnë për të zhvilluar marrëdhëniet ushqyese për të cilat kemi nevojë për të qenë të efektshëm në shërbesë. Perëndia nuk na ka thirrur që të punojmë vetëm.

Ndërtoni një skuadër.

Skuadra e një shërbese ofron mbështetje të brendshme. Për këtë arsye, Jezusi i dërgoi punëtorët dy e nga dy. Një skuadër gjithashtu mundëson përmbushje dhe efikasitet më të madh, ndërkohë që secili person shërben në fushën e dhuntive të tij ose të saj.

Mund të jetë acaruese për një pastor kur është i vetëm dhe përpiqet të jetë i kudondodhur dhe i gjithanshëm, ndërkohë që kufizon përdorimin e dhuntive të tij të vërteta. Merrni pak në konsideratë shërbesat për të cilat kanë përgjegjësi pastorët e kishave të vogla: predikimin, mësimdhënien, dishepullizimin, këshillimin, adhurimin, administrimin, edukimin e krishterë, të rinjtë, fëmijët. Po të shtojmë aty edhe mirëmbajtjen, programin e Krishtlindjes dhe një projekt ndërtimi, gjithashtu dhe sferat në të cilat këta pastorë ndihen të paafte vetëm sa zmadhohen.

Edhe pse një kishë e vogël mund të mos jetë në gjendje të punësojë më shumë staf, qoftë edhe me kohë të pjesshme, ekzistojnë disa mënyra krijuese për të ndërtuar një skuadër shërbese. Bashkë me rritjen e jetëgjatësisë, pensionistët kanë më shumë vite me shëndet të mirë që mund t'i ofrojnë shërbim Perëndisë si vullnetarë. Sot studentët që janë diplomuar në shërbesë nga kolegjet e Biblës janë shumë herë më tepër sesa vendet e paguara të punës që mund të gjejnë. Në rast se komunikojmë një vizion të besueshëm dhe nëse ofrojmë mentorim cilësor dhe mundësi për rritje, disa nga këta të

diplomuar mund ta mbërthejnë vizionin, të gjejnë një punë si "tendapunues", dhe t'i bashkohen skuadrës sonë.

Një opsion paksa i guximshëm është që dy ose tre shërbestarë të ndajnë mes tyre një rrogë dhe të gjejnë punë si "tendapunues" për të plotësuar rrogën e tyre. Kjo mund të jetë veçanërisht e pëlqyeshme në ato komunitete ku një kishë me staf të përshtatshëm ka potencial të madh për t'u rritur.

Rrituni në aftësi.

Pastorët e kishave të të gjitha madhësive kanë nevojë që rregullisht ta "mprehin mirë lapsin" duke i përmirësuar aftësitë e tyre, në vend që të këmbëngulin duke përdorur të njëjtin laps të pamprehur. Justifikimi më i zakonshëm është "jam shumë i zënë". Megjithatë, veçimi i një apo dy orëve në javë për të mësuar nuk është luks, por një domosdoshmëri. Mungesa e aftësive është harxhim kohe dhe sjell shkurajim.

Blini, merrni hua dhe ndani libra të mirë, artikuj akademikë dhe CD që flasin për udhëheqjen dhe shërbesën. Vendoseni si prioritet për të marrë pjesë në seminare apo kampe për shërbestarë ose që të regjistroheni në një kurs që merret me pasurimin e shërbesave.

Të qenit pastor në kisha të vogla është një punë e madhe, por kishat e vogla kanë dinamika të veçanta për t'i dhënë lavdi Perëndisë. Kur Fryma i aftëson, kishat e vogla mund të kenë shërbesa më të mira sesa kishat më të mëdha.

SHËNIME

1. *Christian Schwarz, Healthy Church Development (Carol Stream: ChurchSmart Resources, 1996), 48. Përveç rasteve kur thuhet ndryshe, statistikat e përdorura vijnë nga ky libër.*
2. *Dallas Willard, The Divine Conspiracy (San Francisco: Harper Collins, 1998), 301.*
3. *Ron Klassen dhe John Koessler, No Little Places (Grand Rapids: Baker Books, 1996), 86.*



STEPHEN LIM, D.Min., ka folur në konferenca të ndryshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe në Azi. Ai shërben si ndihmës profesor i udhëheqjes dhe i shërbesës në Seminarin Teologjik të Asambleve të Perëndisë në Springfield, Misuri. Ai banon në San Francisko. Kaliforni.

Si të bini në dashuri me KISHËN tuaj

Nga: NEIL B. WISEMAN

“Dashuria dhe martesë shkojnë bashkë si kali me karrocën” thotë një këngë. Por disa shekuj përpara se të shkruhej kjo këngë, apostulli Pal shkroi disa vargje të ngjashme me këto rreth dashurisë dhe martesës, të cilat ndoshta mund të mos jenë përshtatur kurrë me një melodi. Këto dy këngë pajtohen me njëra-tjetrën me idenë se dashuria dhe martesë shkojnë bashkë, krah për krah.



Megjithatë, apostulli i shton këngës së tij disa përbërës domethënës. Në 11 vargjet e shkurtra të atij pasazhi fisnik, por të vështirë te Letra Drejtuar Efesianëve 5:22 - 33, Pali diskuton për një kishë të pastër, të shenjtë dhe rrezatuese; kryesinë e Krishtit mbi kishën, nënshtrimin reciprok; si dhe për dashurinë midis burrit dhe gruas. Pastaj, sikur të ndjente se këto ide ishin tepër të mëdha madje edhe për të, Pali shkroi këtë fjali të fortë: “Ky mister është i madh; por unë e them në lidhje me Krishtin dhe me kishën” (Efesianëve 5:32).

Komentuesit e Biblës debatojnë se kujt i referohet fjala “mister” këtu, martesës apo kishës. Unë mendoj se iu referohet të dyjave. Çdo çift në një martesë të lumtur e di se martesë është një mrekulli, një mister dhe një lidhje e kënaqshme, të gjitha të mbështjella në një gjë të vetme. Kush mund ta shpjegojë se si një burrë dhe një grua, që janë kaq të ndryshëm nga njëri-tjetri si fizikisht, emocionalisht dhe hormonalisht, munden të ndërtojnë së bashku një jetë të lumtur? Pali ka të drejtë: ky është një mister i jashtëzakonshëm. Kur dikush e lexon këtë fragment nga Shkrimi dhe përpiket që të analizojë kuptimin e tij, dallohet se ai flet në mënyrë të thellë se si shërbestarët mund të zhvillojnë një marrëdhënie të lumtur e të dashur me bashkësitë e tyre.

Dashuria jonë mund të mos krahasohet kurrë me dashurinë e Krishtit, megjithatë, ai është modeli ynë. Si për ta komplikuar edhe më shumë detyrën tonë, është më e lehtë të duash disa kisha sesa disa të tjera. E njëjta gjë vlen edhe për disa pastorë.

LIDHJA E DASHURISË - NJË PJESE THELBËSORE PËR SHËRBESËN

Një lidhje e dashurisë, qoftë e lehtë apo e vështirë, duhet të krijohet midis pastorit dhe njerëzve, sepse efikasiteti i një kishë varet nga ekzistenca e marrëdhënieve të shëndetshme midis bashkësisë dhe pastorit të saj. Marrëdhënia e dyanshme e dashurisë midis pastorit dhe bashkësisë nuk është e vetmja gjë që ka rëndësi në një kishë, megjithëse shumë pak gjëra të tjera kanë rëndësi pa të.

Më poshtë do të gjeni disa mënyra për ta thelluar lidhjen tuaj të dashurisë me bashkësinë tuaj dhe t'i bëni ata që t'ju duan më shumë.

Fillojeni si duhet - a mund të jetë dashuri kjo?

Kur një pastor i ardhshëm merr shkëndijën e parë të thirrjes drejt një kishë, ka ardhur koha që ai të bëjë pyetjen: “A mund të jetë ky fillimi i diçkaje të jashtëzakonshme? A po na sjell Perëndia bashkë? A do të përshtatem atje? A është kjo një dashuri me shikim të parë? A është afrimiteti ai i duhuri?”.

Iu tregoni njerëzve tuaj se jeni shumë i privilegjuar që jeni pastori i tyre.

Ashtu siç ndodh në një martesë, përgjigjet do të jenë unike dhe të ndryshme për çdo individ. Pyesni një çift të martuar se si janë takuar dhe si kanë rënë në dashuri. Me shumë mundësi historia do të jetë unike dhe ndonjëherë gati-gati absurde ose komike. Madje edhe ata që kanë 50 vjet të martuar mund të qeshin nën hundë si adoleshentë kur tregojnë historinë e tyre. Ndërkohë që shpalosin historinë e tyre, përbërësit e marrëdhënies së tyre mund të mos duken si një themel i patundur për një martesë të fortë. Por ky është pikërisht themeli mbi të cilin kanë ndërtuar dhe nuk është edhe aq e rëndësishme se si i duket kjo një të jashtmi.

Në po të njëjtën mënyrë, edhe në fillimet e marrëdhënies midis një pastori dhe një bashkësie nevojitet që “tërheqja” mes tyre të jetë e fortë, e dashur, frymërore dhe emocionale. Ashtu si tek një martesë, përbërësit do të jenë unikë. Por pastori i ardhshëm duhet të jetë i bindur që një marrëdhënie me dashuri mund të themelohet dhe të ruhet ose përmdryshe nuk ka kuptim që të pranohet një detyrë e re.

Thoni: “Ju dua”.

Iu tregoni njerëzve tuaj se jeni shumë i privilegjuar që jeni pastori i tyre. Pastaj shihni të mirat që ju vijnë kur komunikoni dashuri. Çdo fjalë me dashuri i kujton dikujt dashurinë e Jezusit. Çdo fjalë me dashuri shërben si një bumerang (diçka që të kthehet mbrapsht); dikush në bashkësi do t'ia kthejë atë dashuri pastorit me të njëjtën mënyrë. Dhe çdo fjalë me dashuri e rrit shpirtin e atij nga i cili doli. Praktikojini fjalët në shtëpi si dhe gjatë studimit tuaj në mënyrë që të jeni në gjendje ta thoni pa asnjë pikë hezitimi: “Ju dua me dashurinë e Zotit”.

Jini mirënjohës që edhe ata ju duan.

Disa pastorë besojnë se kisha është e detyruar që t'i trajtojë ata si të jenë mbretër. Gjatë mesomoshës, edhe pas saj, disa pastorë besojnë se ata e kanë mbyllur kapitullin e tyre dhe tani kisha u detyrohet diçka për të gjitha vitet që kanë dhënë në shërbim. Ky nocion i rremë nuk tingëllon si sakrifica, bindja dhe vdekja ndaj vetes që fillon të kryqi.

Mendoni pak se sa të pasur jeni në të vërtetë. Jeni fëmija i Mbretit në shërbim të popullit të mbretit. Ne predikojmë nga foltorja e tij dhe punojmë në zyrën e tij. Ne e përfaqësojmë mbretin çdo ditë në mesin e popullit të tij. Ne flasim në emër të tij dhe mbikëqyrim kishën e tij. Por, në mënyrë të mençur, kujtohem se nuk jemi ne mbreti. Mbreti nuk ka kurrë për qëllim që ndonjë prej nesh të lartësohet apo të llastohet.

Jini të denjë për t'u nderuar.

Të gjithë pastorët e dinë qortimin biblik që i jepet popullit të Perëndisë për t'u dhënë nderim të veçantë udhëheqësve frymërorë. Në dy nga letrat e Palit jepet kjo porosi për nderimin. Në fragmentin nga Letra e Parë Drejtuar Thesalonikasve, ai tha: "Por ju lutemi, vëllezër, t'i njihni ata që mundohen midis jush dhe që janë në krye ndër ju në Zotin dhe që ju qortojnë, edhe t'i vlerësoni tej mase në dashuri për veprën e tyre, jetoni në paqe midis jush" (1 Thesalonikasve 5:12, 13). Dhe Pali sugjeron përsëri nderim, madje nderim të dyfishtë: "Pleqtë që qeverisin mirë, le të nderohen dyfish, sidomos ata që mundohen në fjalë e mësim" (1 Timoteut 5:17).

Por në punët tona të përditshme, habia dhe mrekullia që jemi të veçuar për shërbesë nga Zoti sovran ka tendencën që të zbehet. Prandaj kemi nevojë për një ndjenjë të ripërtërirë të përgjegjësisë për ta bërë mirë shërbesën dhe për të kënaqur Perëndinë. Pastaj, edhe mënyra jonë e mendimit në periudhë afatgjatë duhet të marrë formë nga një kuptim më i thellë i llogaridhënies përfundimtare që do të japim për shërbimin tonë pastoral.

Duajini njerëzit pa kushte.

Vlerësojini njerëzit si trofe të hirit. Karakteristika bazë e kishës së Dhjatës së Re është një dashuri që shëron marrëdhëniet e copëtuara njerëzore, që zbut keqkuptimet shkatërrimtare, që ushqen faljen me gjithë zemër, që inkurajon një miqësi të vërtetë dhe motivon dëshminë efikase. Perëndia e krijoi kishën e tij për njerëzit, jo për denominacionet, apo për sisteme teologjike, për veprime sociale dhe madje as për pastorët. Ai dëshiron që kisha të fitojë njerëz, të zhvillojë njerëz dhe që të përfshijë njerëz në shërbimin ndaj botës.

Një pastor i vjetër ka thënë: "Qëllimi parësor i deleve është që të ndërlikojnë jetën e bariut, dhe askush nuk duhet t'i mësojë si ta bëjnë atë". Në rast se presim t'i duam njerëzit kur të bëhen ata që duam ne të bëhen, atëherë mund të presim për një kohë të gjatë. Detyra jonë, me hirin e Perëndisë, është që t'i duam ata ashtu siç janë ndërkohë që besojmë në potencialin e tyre.

Mos u tronditni nga larmia që gjendet tek njerëzit.

Një lidhje e dashurisë, qoftë e lehtë apo e vështirë, duhet të krijohet midis pastorit dhe njerëzve, sepse efikasiteti i një kishe varet nga ekzistenca e marrëdhënieve të shëndetshme midis bashkësisë dhe pastorit të saj.

Në librin *Pastors at Greater Risk* (Pastorët në rrezik të madh), unë dhe H. B. London tregojmë historinë e një drejtuesi të thjeshtë në bashkësinë e tij, i cili e ndihmoi kishën ku shërbente të bënte gjithçka që kishte në dorë për të nderuar, madje të siguronin nderim të dyfishtë, për pastorin e tyre të ri. Por pastaj, ai e pyet këshilltarin e kishës i cili kishte dhënë ndihmë për të gjetur pastorin e ri: "A i kujton ndokush pastorët se fragmentet nga Bibla që flasin për nderimin janë të dyanshme?". Ky drejtues besnik ka të drejtë. Pasazhi thotë se pjesa e pastorit është të punojë fort, të drejtojë kishën dhe të qortoje popullin e Perëndisë. Nderimi i dyfishtë është për ata që japin mësim dhe predikojnë.

Disa njerëz janë shpirtmëdhenj, të tjerë janë grindavecë; disa janë të urtë, të tjerë të marrë; disa janë të mrekullueshëm, të tjerë të çuditshëm; disa janë të ndjeshëm, të tjerë egoistë; disa janë të besueshëm, të tjerë të padobishëm; disa janë falenderues, të tjerë lëndohen kollaj. Dhe të gjithë ata kanë nevojë për një bari që t'i dojë mjaftueshëm për t'u treguar rrugën e shtëpisë për tek Perëndia.

C. S. Lewis ishte nismëtar i mundësive pozitive të shumëllojshmërisë: "Sepse kisha nuk është një shoqëri njerëzore me njerëz që janë bashkuar me anë të prirjes së tyre të natyrshme, por me anë të trupit të Krishtit, ku të gjithë anëtarët, pavarësisht se



sa të ndryshëm, duhet të jenë pjesë e një jete të përbashkët, duke plotësuar dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin pikërisht nëpërmjet ndryshimeve të tyre”.¹

Kisha ekziston për njerëzit. Kini besim tek ata. Kujdesuni për ata. Ndhimojini që të zbulojnë potencialin e tyre të plotë.

Përkushtohuni ndaj një angazhimi jetëgjatë.

Kjo histori është nga gazeta e të dielës në qytetin tonë. Një burrë, i cili i kishte kaluar me kohë të 85-at, e pyetën ndërkohë që po i afrohej përvjetori i tij i 67-të i martesës: “Cila është këshilla juaj për bashkëshortët më të rinj?”.

Ai u përgjigj: “Duhet të vazhdoni të bëni atë që keni bërë në fillim për t’i fituar asaj zemrën”. Mund të gjejmë diçka të mirë dhe të dobishme tek kjo këshillë për marrëdhënien e dashurisë së një pastori me një kishë.

Por si t’ia bëjmë atëherë kur ndjenjat e dashurisë të kenë avulluar? Një këshilltare e urtë dikur u shkroi lexuesve të saj: “Vazhdoni të bëni vepra dashurie dhe ndjenja do të vijë më pas”.

Predikoni dashuri.

Shkoni përsëri tek Bibla dhe ushqejeni shpirtin tuaj duke lexuar pasazhet e dashurisë. Mësojini njerëzit tuaj vazhdimisht se dashuria jonë për njëri-tjetrin del natyrshëm nga dashuria që Perëndia ka për ne. Tregojuni se dashuria është një dhuratë që e marrim nga Perëndia dhe ua transmetojmë atyre që kemi përreth.

**Kisha ekziston për
njerëzit. Kini besim tek ata.
Kujdesuni për ata. Ndhimojini
të zbulojnë potencialin
e tyre të plotë.**

Përpiquuni të ndërtoni një atmosferë frymërore në kishën tuaj e cila përmbush këtë sfidë biblike: “Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne, si blatë dhe flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë” (Efes. 5:1, 2).

Bëhuni një person i plotë.

Karakteri ka vlerë. Prej nesh pritet që të kemi devotshmëri personale. Ajo që jemi i paraprin asaj që bëjmë dhe karakteri është burimi i sjelljes. Shumica e bashkësive, në rast se do t'u duhej që të zgjidhnin midis një shërbestari të shkathët dhe një shërbestari të shenjtë, do të zgjidhnin të shenjtin. Në këtë epokë të mosfunksionimit dhe të zemër-thyerjes së paprecedentë, kisha ndonjëherë kthehet në ndalesën e fundit për njerëzit e lënduar e të pështjelluar apo për ata që e kanë jetën lëshuar. Dhe kisha, për ta, kthehet në një strehë mikpritëse. Si rrjedhojë, shumë prej tyre gjejnë një jetë të re në Krishtin, një jetë të transformuar me fillime të reja. Por në proces e sipër, disa kanë një ose më shumë probleme paksa ngulmuese, qoftë një zakon i keq, një plagë, një pikë e dobët apo një mëkat i fshehtë. Bëni ç'të mundeni për t'i ndrequr ato vende të thyera dhe për t'i shëruar ato lëndime.

Dështimi për të përdorur njerëzit e fortë dhe dëshira për të kontrolluar çdo shërbesë dhe program, janë dy faktorë kryesorë që i mbajnë kishat të vogla.

Për të qenë një shërbestar efikas i ungjillit, pastori i duhet të jetë krejtësisht i varur tek Perëndia. Pastori që përpiket të shërbejë me forcat njerëzore nuk ka më shumë për të dhënë sesa një avokat, inxhinier apo doktor. Është pikërisht ajo gjëja shtesë në jetët tona, pra, hiri, prania dhe fuqia e Perëndisë, që na bën fitimtarë dhe të efektshëm, dhe ndihmon për t'i bindur njerëzit se ajo që predikojmë është origjinale dhe e vërtetë.

Apostulli Pal e theksoi çështjen e të qenit të plotë në këtë deklaratë të fuqishme përmbledhëse: "Bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në frymë, në besim dhe në dëlirësi. Kushtoj leximit, nxitjes dhe dhënies së mësimi" (1 Timoteut 4:12, 13).

Bëjini një nder bashkësisë suaj; përpiquni të kuptoni vetveten.

Në çfarë mënyre mendoni? Cilat janë reagimet tuaja të parashikueshme? Cila është forca shtytëse në jetën tuaj? Cilat janë motivet tuaja?

Kuptimi i vetvetes është një çelës i rëndësishëm për të kuptuar të tjerët. Vëriti motivet tuaja në dyshim, duke pyetur: **"Përse e bëra këtë?"**. Shqyrtoni veten tuaj për mënyrën se si i drejtoni takimet. Kontrolloni veten se si i shpenzoni paratë. Kjo tregon shumëçka në lidhje me karakterin tuaj. Pyesni veten për të përcaktuar nëse i manipuloni detyrat administrative

që të bëhet ashtu siç thoni ju dhe pastaj i justifikoni veprimet tuaja duke thënë se ky ishte vullneti i Perëndisë.

Konsiderojeni thirrjen tuaj si një detyrë hyjnore.

Apostulli Pal e pa punën e tij si një detyrë të dhënë nga Perëndia. Për shembull, ai iu tha galatasve: "Po, kur i pëlqeu Perëndisë, që më kishte ndarë që nga barku i nënës dhe më thirri me anë të hirit të tij, që të zbulojë në mua Birin e tij, që unë ta predikoj midis paganëve, unë nuk mora menjëherë këshillë nga mishi dhe gjaku" (Gal. 1:15,16). Çfarë deklarate! Shihni pak përbërësit e thirrjes së apostullit: i ndarë për shërbesë që përpara se të lindte; i thirrur me anë të hirit; një besueshmëri dhe një gëzim ndërkohë që Jezusi u zbulua në jetën dhe shërbesën e tij; dhe një thirrje hyjnore për paganët e kohës së tij.

Një thirrje hyjnore siguron muskuj, fuqi dhe motivim për shërbesë. Thirrja hyjnore ndihmon për të zhvilluar një ndjenjë misioni dhe një vetëdije të aftësisë të shenjtë, në mënyrë që njeriu i Perëndisë të mund të përpiket dhe të kryejë më shumë nga sa mendon se mundet. Thirrja e jetuar në praktikë jep këmbëngulje, një autoritet për të predikuar dhe një fuqizim për të dashur të gjithë ata që i do edhe Zoti, pra, të gjithë ata që takojmë.

Shijojeni shërbesën si një mënyrë jetese.

Edhe pse shërbesa mund të shihet qoftë si profesion, qoftë si thirrje, thelbi i saj është kauza më e madhe që njeh sot njerëzimi. Ashtu si prindërimi, edhe shërbesa është ditë e natë, orë pa orë, gjithë vitin. Ky realitet i shërbesës mund të pranohet me gëzim ose të kundërshtohet, por gjithsesi mbetet një fakt.

Shqyrtoni perspektivën e Perëndisë për detyrën tuaj.

Kur Perëndia ju dërgon diku, ai di gjithçka në lidhje me atë vend, dhe i njeh mirë aftësitë tuaja, formimin dhe potencialin tuaj. Kur ju ofrohet ose kur pranohet një detyrë që duket se është brenda vullnetit të Perëndisë, pyesni veten se çfarë ka Perëndia ndër mend për ju që të përmbushni në atë vend. Kur Perëndia ju dërgon, duhet të qëndroni aty derisa plani i tij të jetë përmbushur.

Tregoni ëndrrat, imagjinatat dhe krijimtarinë.

Shpeshherë kisha duket jashtëzakonisht e lidhur pas traditës. Realiteti mahnitës, ndoshta edhe për të qeshur, është se një pjesë e mirë e asaj që konsiderohet si traditë në kohën tonë filloi si një aventurë e re në një epokë më të hershme. Historia e shkollës të së dielës, e misioneve moderne dhe e orarit të shërbesës së adhurimit në orën 11 paradite të dielave, për t'u dhënë fermerëve kohë për të mbaruar punët e tyre përpara se të vinin në kishë, ishin risitë më të fundit në atë kohë. Dhe ndoshta njerëzit atëherë mendonin me vete: "S'i kemi bërë asnjëherë kështu gjërat më parë".

Mbajtja e një balance të shëndetshme mes të ardhmes, të kaluarës dhe të tashmes është goxha punë në shërbesë. Çdo kishë dhe individ janë të formuar përmes historisë së tyre. Traditat duhen njohur dhe ndonjëherë ndryshimi vjen shumë ngadalë. Ndërkohë, e tashmja është domethënëse dhe e ardhmja është e ndritur aq sa premtimet e Perëndisë.

Disa shërbestarë e kalojnë jetën e tyre duke u mbërtshyer pas mundësisë për një të ardhme që nuk vjen kurrë. Të tjerët jetojnë në të tashmen, pa e vrarë shumë mendjen për të shkuarën dhe pa ëndërruar për të ardhmen. Shpesh puna e tyre është si një lule e këputur, e bukur, por pa rrënjë. Një ilaç i mirë për këtë është që ta mendojmë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen si histori, arritje dhe shpresë dhe t'i mbajmë ato në mendjen tonë në një tension krijues. Çdo ditë në një partneritet shërbese me Perëndinë është një ditë e mirë në qoftë se e dimë se çfarë të bëjmë me të.

Rrisni njerëz të mëdhenj.

Për vite me radhë, programet për rritjen e kishës dhe për ungjillëzimin kanë ofruar mënyra për të rritur kisha të mëdha. A është e mundur që kur një bashkësi rrit njerëz të mëdhenj, rezultati i marrëdhënies së tyre me Zotin dhe me njëri-tjetrin të jetë rritja e kishave të mëdha? Ndërtimi i njerëz të mëdhenj duke i inkurajuar ata që ta japin veten për një kauzë të madhe. Një poet ka thënë: "Jepeni veten tuaj për një kauzë të madhe. Ndoshta nuk do t'i sillni shumë dobi kauzës, por ajo do t'ju sjellë juve shumë dobi".

Jepuni njerëzve vlerë kur vijnë në kishë.

Çdo shërbesë duhet t'i shtojë vlerë lehtësisht të dukshme jetëve të atyre që janë të pranishëm. Çdo person ka të drejtën për t'u ushqyer, për t'u inkurajuar dhe për t'u frymëzuar kur vjen në kishë. Njerëzit kanë nevojë për udhëzim, frymëzim, inkurajim dhe shpresë. Njerëzit nuk kanë nevojë që të shahen, që të ofendohen apo që t'u flitet me përçmim. Kjo ndodh

mjaft shpesh në botë. Numri i pjesëmarrësve në kishë mund të rritet në mënyrë dramatike shpeshherë duke i bërë shërbesat më të përshtatshme, më frymëzuese dhe më pak të mërzitshme. Ndërsa përgatisni çdo shërbesë, pyesni veten: "**Çfarë do të duan të marrin njerëzit nga kisha herën tjetër që takohemi?**".

Çojeni dashurinë tek problemet e besimtarëve.

Eventualisht të gjitha qeniet njerëzore ndeshen me humbjen, aksidentin, sëmundjet apo lëndimin në udhën e tyre të jetës. Thelbi i shërbesës së krishterë qëndron në të qenit përfaqësuesit me mish dhe me gjak të Jezusit në kohët kur nevoja është më e madhe. Jini prezent. Shkoni në dashuri, por edhe shpesh, derisa kriza të ketë kaluar. Ata që po kalojnë nëpër atë luginë do t'ju duan përgjithmonë. Kur të tjerët ju shohin që i ofroni kujdes me dashuri atyre që kanë nevojë më shumë për të, atëherë në të gjithë kishën do të ketë si rrjedhojë më shumë besueshmëri tek shërbesat.

Vlerësojeni shërbimin e krishterë si një dhuratë dashurie nga perëndia.

Sot, shumë njerëz që shkojnë nëpër kisha janë mbipeshë nga ana frymërore, për shkak të konsumimit të tepërt të ushqimeve të pashëndetshme dhe mungesës së "mishit" dhe të "përmbajtjes". Ata kanë nevojë për më shumë ushtrime në shërbesën ndaj Perëndisë dhe ndaj njerëzve.

Shumë mundësi janë të mbështjella në tri fokuset thelbësore të shërbimit të krishterë. Mendoni për to si këmbët e një stoli me tri këmbë. Së pari, shërbimi është ajo që bëjmë për Perëndinë. Së dyti, shërbimi është ajo që bëjmë për të tjerët. Së treti, dhe shpesh një përbërës i anashkaluar, është pasurimi (frymëror) ynë personal kur iu shërbejmë të tjerëve.

Predikuesi predikon në mënyrë që Perëndia t'i ndihmojë të tjerët që ta njohin më mirë Perëndinë. Por kur ai predikon, Fjala kërkon ta gjejë dhe ai përmirësohet dhe, në proces e sipër, zhvillon një shpirt më të madh.

Mësuesi i shkollës të së dielës mëson që Perëndia t'i ndihmojë të tjerët të mësojnë si ta vënë Shkrimin në zbatim në jetët e tyre, dhe gjithashtu rritet në mirëqenien e vet frymërore. Kjo pikëpamje e zhvendos shërbimin nga një punë dhe detyrim në privilegj dhe bekim.

Pranoni dhe përfshini njerëz të fortë.

Disa pastorë ndihen të kërcënuar nga njerëz të fortë dhe të aftë. Dhe disa nuk ndihen rehat kur iu drejto-

het pyetja: “Po pse?”. Disa udhëheqës frymërorë i vënë në dyshim motivet e njerëzve të fortë, veçanërisht ata që duan punë të shkëlqyer dhe me efikasitet. Dy nga faktorët domethënës që i mbajnë të vogla kishat janë dështimi për t'i vënë në përdorim njerëzit e fortë dhe dëshira për të kontrolluar çdo shërbesë apo program. Nevoja që kanë disa persona për të kontrolluar çdo detaj të jetës së bashkësisë i vë një “tavan” rritjes dhe e dëmton gjendjen morale.

Merrni udhëheqjen e familjes së Perëndisë.

Familja biologjike ndodhet nën një rrethim të tmerrshëm. Pothuajse të gjithë duhet të ndihmojnë për të forcuar familjen e tyre. Disave iu duhet një familje zëvendësuese për të zënë vendin e familjes që kurrë nuk e kanë pasur apo të familjes që kanë humbur. Shumë njerëz kanë zemra të thyera. Miqësia, pranimi, mbështetja dhe llogaridhënia e një kishe të dashur janë sot më të nevojshme se kurrë më parë. Mund ta quani çfarë të doni mundësinë për të udhëhequr familjen e Perëndisë: **kreu** i klanit, **drejtuesi** i familjes së gjerë të humbur, **themeluesi** i familjes zëvendësuese apo **pastori** i familjes së Perëndisë. Por sigurohuni që të bëhet puna dhe që të krijohen marrëdhënie të dashura.

SHËRBESA PARAQET MUNDËSI MADHËSHTORE PËR TË TREGUAR DHE PËR TË MARRË DASHURI

A e mbani mend se kush ishit kur morët thirrjen? A e mbani mend se si e përdori Perëndia dashurinë tuaj për Të në mënyrë që t'ju ndihmonte të shihnit nevojat e botës së tij? Duhet të ketë qenë një moment përcaktues për shërbesën tuaj, apo jo? Atë ditë, Zoti sovran ju thirri në një tokë të panjohur me premtimin se do të jetë me ju, do t'ju fuqizojë dhe do t'ju dojë pa kushte. Shumë vargje nga Shkrimi na ndihmojnë për të kuptuar punën e shërbesës. Ndërsa fragmente të tjera na ngarkojnë dhe na sfidojnë me detyrën dhe nevojën. Por, në mënyrë të vazhdueshme, motivi, gjendja emocionale dhe domethënia e shërbesës është dashuria.

Rëndësia dhe prioriteti i dashurisë tregohet në mënyrë të qartë në përgjigjen që Jezusi i jep pyetjes: “Cili është urdhërimi i madh?”. Dhe Jezusi i tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, dhe me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde.” Ky është urdhërimi i parë dhe i madh. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten”.

Pastaj ai shton një fjali të jashtëzakonshme përmbledhëse: “Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët” (Mateu 22:37-40). Jezusi e konsidronte

të rëndësishme dashurinë për Perëndinë dhe për të afërmin.

Duke ndjekur shembullin e Zotit të tij, edhe Pali gjithashtu e vendos dashurinë në qendër të punës sonë, duke shkruar se: “[Dashuria] i duron të gjitha, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, mban çdo gjë” (1 Korintasve 13:7).

Pasi lexojmë këto fragmente, prova është e padiskutueshme: shërbesa është dashuri për Perëndinë, për të afërmin dhe për veten. Kjo dashuri për Perëndinë dhe për të afërmin na jep një biletë për gjithë jetën në vendet private dhe publike dhe në vendet e trishtuara dhe të gëzuara.

Dashuria për Jezusin na jep mundësinë për ta përfaqësuar atë nëpër dasma, përreth varreve, në pagëzime, në dhomat e pritjes së spitaleve, në shërbesat e bashkësisë, në adhurim dhe në predikim. Gëzimi dhe aventura e shërbesës duhet të theksohet vazhdimisht me fjalë të tilla si **ëndje, hare, kënaqësi, qetësi dhe arritje e përjetshme**. Vetëm brenda një jave, një pastor shikon më tepër nga veprat që Perëndia po bën, sesa shihet nga shumica e njerëzve në gjithë jetën e tyre.

Dashuria për Krishtin ndihmon që ta mbajmë shërbesën të përqendruar. Kur dimensionin e dashurisë duket se po zbehet, kujtohuni për gjendjen e gjërave në botën reale dhe ajo do të ndriçojë përsëri. Në mesin e përbërësve të gjërave në botën reale është kjo: Perëndia ju do. Shumica e njerëzve, në mos të gjithë, ju duan dhe ju keni mundësinë që gjithashtu t'i doni.

Hidhini krahët shërbesës suaj për ta përqafuar atë. Duajini njerëzit që Perëndia ju ka dhënë për t'iu shërbyer dhe ata do t'ju duan gjithashtu në mënyra që janë përtej ëndrrave tuaja më të mëdha.

Shënim

1. Wayne Martindale, dhe Jerry Root (*Kontribuuesit*), **The Quotable Lewis**, (Wheaton, Ill.: Tyndale House Publishers, 1989), 105.



NEIL B. WISEMAN është një shkrimtar, folës dhe arsimtar. Ai gjithashtu shërben si themeluesi dhe drejtori i Institutit të Kishës së Vogël.

A smiling pregnant woman with long brown hair, wearing a grey short-sleeved top and a red skirt, holding a book. The background is blurred, showing a person in a blue shirt.

Duke u ATËHERË NUK PO

rritur: KUR ASKUSH JU SHEH

Nga: **MARCIA LEDNICKY**

Teksa i shohim fëmijët të rriten, është gati-gati e pamundur që të vëmë re rritjen e tyre, përveçse kur kemi një vit që nuk i shohim. Ndryshimet janë goxha dramatike. Është sigurisht e dukshme që ata të rriten në shtat, por zakonisht janë edhe më të pjekur nga ana emocionale dhe nga mënyra e sjelljes. Prandaj edhe themi se fëmijët “po rriten”. Kjo ishte dëshira e Palit për besimtarët në Efes, ndërkohë që ai i inkurajonte ata që të “rriten në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti” (Efesianëve 4:12-16).

Si ta “rrisim” një kishë? Kjo pyetje ka shumë përgjigje të mira, ndërkohë që procesi i rritjes frymërore dhe i rritjes numerike për një trup besimtarësh kërkon përkushtim të vazhdueshëm. Kishën e risim me anë të lutjes, të predikimit të vajosur të Fjalës, të fuqisë së Frymës së Shenjtë, dhe me anë të *një pune të palodhshme!* Ky artikull do të flasë për disa mënyra praktike për të ndikuar tek të tjerët që të kthehen në ndjekës të Krishtit dhe në dishepuj të pjekur.

Të gjitha kishat janë të përfshira në shërbesën e mikpritjes edhe pse kjo shërbesë nuk ka marrë një emër të caktuar. Një nga prioritetet kryesore për çdo kishë vendore duhet të jetë përfshirja e të gjithë

anëtarëve të saj në miqësi, duke u përpjekur që t’i sjellë ata në unitetin e dashurisë dhe hirit të Zotit tonë, dhe në të njëjtën kohë, për të zhvilluar marrëdhënie me besimtarët e tjerë. Dhe për të përmbushur këtë, Perëndia përdor anëtarët e familjes së tij.

Fjala “mikpritje” në kuptimin e saj të drejtpërdrejtë do të thotë “të zhvillosh zemrën e një shërbëtori”. Rrënja e kësaj fjale vjen nga dy fjalë nga greqishtja. Fjala “filo” që do të thotë “dikush që ka dashuri” dhe fjala “ksenos” që përkthehet “të huaj”. Pra, me fjalë të tjera, fjala “Filoksenos” do të thotë “dashuri për të huajt”. Vini re, nuk do të thotë dashuri për shokun apo shoqen e ngushtë; përkundrazi: dashuri për të huajt.

Të dashura gra, e kuptoj se të gjithave na pëlqejnë shoqet tona. Ka raste që, përpjekjet tona për t’iu afruar personave të rinj që futen në kishën tonë, mund të na nxjerrin nga zona jonë e rehatisë. Por, apostulli Pjetër i udhëzon besimtarët që të praktikojnë mikpritjen. Tek Letra e Parë e Pjetrit 4:9 thuhet: “*Jini mikpritës njëri për tjetrin, pa murmuritje*”. Do të ishte me vend të themi se mikpritja është arti frymëror për t’i bërë njerëzit që të ndihen rehat, njësoj sikur të ishin në shtëpinë e tyre.

Secila prej nesh ka një përgjegjësi të dhënë nga Perëndia, jo vetëm për të “dalë dhe për t’i detyruar të hyjnë”, por pasi të jenë futur në shtëpinë e Perëndisë, ne duhet të jemi absolutisht të sigurt që të kenë një arsye për t’u rikthyer. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që t’i asimilojmë personat e rinj që vijnë në kishë, duke i bërë sa më shpejt që të jetë e mundur pjesë të miqësisë së dashur të familjes së kishës, përndryshe kisha mund t’i humbasë, ose më keq, Mbretëria e Perëndisë mund t’i humbasë. Në qoftë se gjejmë mënyra për t’i përfshirë mysafirët që hyjnë në vendin tonë të adhurimit, atëherë me të vërtetë që “do të rritemi, edhe atëherë kur askush nuk po vëzhgon”.

Njerëzit tërhiqen nga një kishë e dashur ku vazhdimisht shprehet ngrohtësia dhe shqetësimi i çiltër për nevojat e tyre. Mesazhi i ungjillit nuk ndryshon kurrë; megjithatë, metodat me anë të të cilave e tregojmë këtë të vërtetë të pandryshueshme mund të ndryshojnë në një kulturë e cila është gjithnjë në ndryshim. Në lutjet tona, duhet të kërkojmë urtësinë e Frymës së Shenjtë për të gjetur përqasjen e duhur për t’i shërbyer këtij brezi. Është e rëndësishme që ashtu siç përpiqemi që miqtë që na vijnë në shtëpi t’i bëjmë të ndihen rehat dhe të mirëpritur, po kështu edhe të ftuarit (si dhe pjesëmarrësit e rregullt dhe anëtarët) e kishës sonë të ndihen që janë të mirëpritur dhe të pranuar sa më shpejt që të jetë e mundur. Çelësi këtu është që të jemi “të fokusuar tek njerëzit”. Ndërtimi i marrëdhënieve është një shprehje e vërtetë e marrëdhënies që ne shijojmë si bijtë dhe bijat e Atit qiellor dhe të Birit të tij, Jezu Krisht. Paçka nëse janë fëmijë, të rinj, beqarë, çift me fëmijë apo pleq, secili duhet të respektohet dhe secilit duhet t’i jepet një vend domethënës në familjen e kishës. Zoti dhe shpëtimtari ynë nuk është i gatshëm që ndokush të humbasë. Për rrjedhojë, edhe ne duhet të dëshirojmë me zell që të jemi një enë përmes së cilës Fryma e Shenjtë mund të derdhet për të treguar dashurinë e Krishtit. Ndërkohë që i shohim të tjerët përmes syve të Zotit tonë të mrekullueshëm, shumë shpejt edhe vlera e secilit individ bëhet e dukshme. Me anë të hirit të Perëndisë që punon në zemrat tona, synimi ynë është që qëllimisht të bëjmë një investim të përjetshëm te secili person që Zoti vendos në sferën tonë personale të influencës. Buzëqeshni; përshëndesni miqësisht dhe ngrohtësisht; i mirëprisni me sinjeritet njerëzit në shërbesën apo aktivitetin e kishës; mësoni emrat e tyre. Pasi të kenë hapur zemrat e tyre dhe pasi t’ju kenë zbuluar nevojat e tyre vetjake, bëni ç’të mundeni për t’i ngushëlluar dhe për t’i inkurajuar që t’i besojnë plotësisht Jezusit. Ky do të jetë një hap i rëndësishëm si fillim për t’i asimiluar ata në kishën tuaj sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ekziston një shprehje që thotë: “Nuk na jepet një shans i dytë për të lënë përshtypje të parë të mirë”. Statistikat na tregojnë se dikush që është i ftuar për herë të parë në një kishë, brenda njëmbëdhjetë minutave të para, do ta vendosë nëse do të kthehet ose jo në atë kishë. Kjo është vërtet e mahnitshme! Studimet gjithashtu tregojnë se një person zakonisht do t’ju tregojë nëntë deri në dymbëdhjetë miqve rreth përvojës së mirë që pati në kishë. Dhe, sigurisht, kjo funksionon edhe në drejtimin e kundërt. Është e sigurt që do të tregohet edhe çdo përvojë e keqe.

- Shërbesa e mikpritjes për kishën tuaj fillon kur ju dhe udhëheqësit e kishës ndani një dëshirë të përbashkët, një “pasion” për të arritur (konvertimi) dhe për të mësuar (dishepullizimi) komunitetin tuaj për Krishtin. Ju, në cilësinë e pastorit apo gruas së pastorit, mund të jeni një shembull i fuqishëm për të shfaqur shpirtin e vërtetë të mikpritjes biblike. Të jesh duke kërkuar gjithmonë mundësi për t’i ftuar të tjerët në kishë nuk do të thotë thjesht përpjekje për të rritur madhësinë e bashkësisë, por është një dëshirë e bindur për t’i parë të gjithë njerëzit të vijnë në njohjen e Krishtit, Shpenguesit tonë. Kjo mund të ndodhë te tregu apo edhe me një fqinjë në pallat apo në lagje. Në bindje të thjeshtë ndaj urdhërimit të Zotit, shfrytëzoni çdo mundësi për të dëshmuar me anë të jetës suaj dhe për t’i ftuar ato personalisht që të bashkohen me ju në kishë dhe të përjetojnë atë që po bën Perëndia. Jini një shembull ndërsa i përshëndesni vizitorët kur vijnë dhe lutuni bashkë me ta në qoftë se kërkojnë lutje.
- Tek Gjoni 13:35, ku përmenden fjalët e Jezusit, thuhet: “Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin”. Shërbesa e mikpritjes në një kishë shkon përtej aktiviteteve që rrethojnë kohët e programuara të adhurimit. Ka shumë mundësi të tjera për të ushqyer rritjen frymërore në mesin e besimtarëve. Qëllimi është që të zhvillojmë marrëdhënie. Jezusi iu tha dishepujve të tij se “dashuria” duhet të jetë shenja dalluese e të krishterit. Pa asnjë polemikë, Shkrimi e zbulon Jezusin si dikush i cili është i përqendruar tek njerëzit. Ai u kujdes në mënyrë të çiltër për të gjithë. Njerëzit ishin misioni i tij i vetëm për ardhjen në këtë tokë.
- Domethënia e mikpritjes së krishterë duhet t’i mësohet të gjithë bashkësisë. Ky është një vizion i cili duhet përqafuar. Ai nuk është një aktivitet dytësor; përkundrazi, është urdhërim i Fjalës së Perëndisë. Udhëheqja frymërore duhet të rekrutojë besimtarë për të zhvilluar një plan veprimi për trupin vendor. Të dashura bashkëshorte të pastorëve, ka shumë njerëz në bashkësi të cilët

**Jezusi po vjen shumë shpejt!
Bekuar qofshi, të dashura gra,
ndërkohë që të gjitha
“punojmë së bashku deri sa të
vijë Jezusi” për kishën e Tij.**

- Marcia Lednicky



do të përfshihen me gëzim në shërbesën e mikpritjes. Këta individë ndoshta nuk ndihen rehat që të drejtojnë grupin e adhurimit, të japin mësim në shkollën e të dielës apo të bëjnë ndonjë nga shërbesat e tjera në publik apo nga platforma. Megjithatë, në rast se ndjekësit e përkushtuar të Krishtit mund ta përfytyrojnë domethënien që ka mikpritja, dhe të sfidohen për të qenë pjesë në disa aspekte të kësaj shërbese, atëherë do të rrisni një kishë, kur askush nuk po ju sheh.

- Lutuni për të pasur një drejtuese të thirrur nga Perëndia për këtë shërbesë, e cila sheh potencialin për t'ju bërë një fanar i madh në komunitet. Dhe, meqë ra fjala, kjo drejtuese mund të jeni edhe ju. Nëse zgjidhni ta drejtoni këtë shërbesë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të pajisni besimtarët dhe t'i lejoni të marrin bekimet që vijnë bashkë me shërbimin. Kushdo që zgjidhet me kujdes për të drejtuar shërbesën duhet: (1) t'i dojë me të vërtetë njerëzit; (2) të jetë një organizuese; (3) të ketë aftësinë për të motivuar punëtorët e tjerë; dhe (4) të jetë shumë e ndjeshme në çdo kohë ndaj udhëheqjes së Frymës së Shenjtë.
- Mbani një takim organizativ me pastorin dhe me udhëheqjen e kishës. Bëjeni takimin të hapur për të gjithë bashkësinë. Do të habiteni nga numri i njerëzve që do të jenë të pranishëm dhe nga ata që dalin vullnetarë për të shërbyer.
- Është me rëndësi jetike që secili prej punëtorëve të trajnohet në mënyrë të përshtatshme. Në radhë të parë, sigurohuni që ata të jenë të familjarizuar me ambientet e kishës. Bëni një xhiro të ndërtesës gjatë seancës së trajnimit, duke u siguruar që çdo individ të dijë se ku ndodhen të gjitha klasat dhe cilat grupe takohen në secilën klasë. Në këtë

mënyrë, ata mund të jenë të sigurt në ndihmën që iu japin vizitorëve që janë të pranishëm. Nëse shërbesa përfshin disa aspekte, do të ishte e dobishme që të keni disa udhëzime „të shkruara” në mënyrë që secili person të dijë se çfarë pritët prej tij/saj në përmbushjen e detyrës së tij/saj.

Ndërsa mendoni në lutje për të përparuar me zhvillimin e kësaj shërbese të caktuar, është mirë që të merren në konsideratë disa pyetje.

1. A po rritet kisha juaj numerikisht?
2. A po humbisni anëtarë? Në qoftë se po, pse?
3. A kthehen një pjesë apo shumica e të ftuarve “për herë të parë” për një herë të dytë apo të tretë?
4. A është pjesa më e madhe e kishës suaj plotësisht e përkushtuar për zhvillimin dhe për rritjen numerike dhe frymërore?

Këto janë pyetje të vështira, por duhet të marrin përgjigje në mënyrë të ndershme dhe me një mendje të hapur. E vërteta është se ne thjesht duhet t'i asimilojmë ata që vijnë për herë të parë në familjen e kishës sa më shpejt që të jetë e mundur, ose ka shumë gjasa që ata nuk do të qëndrojnë në kishë. Mënyra më e mirë që një i ri në kishë të asimilohet është që të shoqërohet me një grup bërthamë miqsh. Gjithmonë njerëzit do të preferojnë një kishë ku ngrohtësia dhe shqetësimi për nevojat e tyre është në mënyrë të dukshme një prioritet. Është e domosdoshme që të kapim atë që i tërheq njerëzit sot. Unë besoj shumë se njerëzit tërhiqen drejt një vendi ku ata gjejnë “frytet e Frymës” të qëndrimet e veprimet e anëtarëve dhe të udhëheqjes. Shkrimi na jep udhëzime me një listë në të cilën përfshihen *dashuria, gëzimi, paqja, zemërgjerësia, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëpërmbytja* (Galatasve 5:22-23).



Në vijim mund të lexoni një histori të vërtetë të treguar nga një student në degën e mjekësisë, i cili quhet Xhon. Kjo histori e shkurtër ka një mësim shumë të vyer për të gjithë ne.

Një ditë, në një orë mësimi, profesori ynë na bëri një provim të papritur rreth disa materialeve që kishim studiuar javët e fundit. Unë isha student i zellshëm, kështu që i dija përgjigjet e pyetjeve të provimit dhe i kalova pyetjet me shpejtësi derisa shkova tek pyetja e fundit. Pyetja e fundit ishte: “Si e ka emrin gruaja që pastron këtë shkollë?”. Arsyetimi im ishte: “Kjo është patjetër një shaka”. E kisha parë shumë herë pastruesen e shkollës përgjatë viteve që kisha kaluar në shkollë. Madje edhe mund ta përshkruaja se si dukej. Ajo ishte e gjatë, me flokë të zinj dhe me siguri rreth të 50-tave. Por, ç’i duhej emri i pastrueses një studenti të mjekësisë? Në fund të fundit, ç’ndryshim do të përbënte emri i saj nëse unë isha një mjek i aftë apo jo? Ia dorëzoja provimin profesorit, duke e lënë bosh pyetjen e fundit.

Përpara se të dilnim nga klasa, një student tjetër pyeti nëse pyetja e fundit do të llogaritej apo jo te nota e provimit. “Absolutisht, po”, u përgjigj profesori, “në karrierën tuaj do të takoni shumë njerëz. Cilido që takoni është një person i rëndësishëm. Ata meritojnë kujdesin dhe vëmendjen tuaj, edhe sikur ju vetëm të keni mundësinë që t’iu buzëqeshni dhe t’iu thoni „mirëmëngjesi””.

Atë ditë, Xhoni mori një mësim të madh gjatë orës së mjekësisë. Ai mësoi se jeta nuk ka të bëjë vetëm me përmbushjen e afateve, me njohjen e informacionit dhe me të qenit të aftë në profesionin përkatës. Menjëherë të nesërmen, ai mësoi edhe diçka tjetër, ajo e kishte emrin Dorotea. Po, çdo person që takoni është i rëndësishëm. Pse? Sepse Jezusi vdiq në kryq për të shpënuar secilin, ashtu siç bëri për ne. Fryma e Shenjtë dëshiron t’i drejtojë ata te Ati dhe t’i fuqizojë për të jetuar një jetë si fitimtarë. Një tabelë e një kishe shkruante: “Sa më afër të jeni me Perëndinë, aq më e madhe do të jetë zemra juaj për njerëzit”.

NJERËZVE NUK JU INTERESON SE SA DINI, DERISA TË DINË SE SA SHUMË INTERESOHENI PËR TA!

Hapi tjetër në procesin e asimilimit të atyre që vijnë për herë të parë në kishë është që t’i përfshijmë ata plotësisht të paktën në një shërbesë të kishës.

Dhe tani, le të flasim në lidhje me disa gjëra që duhet të përfshihen në një shërbesë me shumë aspekte.

(Mbani mend se ajo që mund të jetë efikase në një kishë nuk mund të jetë domosdoshmërisht po aq efikase në një komunitet apo vendndodhje tjetër).

1. **Ftesa promociionale.** 85% e njerëzve shkojnë në një kishë të caktuar për herë të parë sepse një mik apo familjar i ka ftuar ata personalisht. Skiconi një ftesë të cilën anëtarët tuaj mund t’ia japin personave të mundshëm për të ardhur në kishë. Ftesa duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm në mënyrë që personat që mund të vijnë ta kenë informacionin e plotë (emrin e kishës, adresën, numrin e telefonit, oraret e shërbesave, etj.).
2. **Personat që përshëndesin dhe mikpritësit (bashkë me etiketat e emrit).** Këta individë duhet të vendosen në çdo derë hyrëse për çdo shërbesë adhurimi. Më lejoni të përmend dallimin midis *atij që përshëndet* dhe *mikpritësit*. Ai që përshëndet, nuk largohet kurrë nga pozicioni i tij apo i saj te dera. Ndërsa, mikpritësi e merr dhe e çon mysafirin deri te vendi ku duhet të shkojë. Kjo është shumë e rëndësishme. Mbani mend, mikpritësit duhet të jenë të familjarizuar shumë mirë me ambientet dhe mjediset e kishës. Ata do t’i udhëheqin, pa asnjë hezitim, mysafirët te dhoma e duhur. Mos jepni vetëm udhëzime gojore; por më mirë i shoqëroni individët derisa të prezantohen me dikë te dhoma, persona të cilët, po ashtu, do të kujdesen për ta.
3. **Shërbesë telefonike.** Kjo është një shërbesë përmes së cilës secili mysafir do të marrë një telefonatë brenda 24 orëve nga vizita e tij në kishë. Kjo nuk është një telefonatë teologjike për të diskutuar parimet tuaja të besimit. Në rast se është e mundur, telefonata duhet të bëhet të dielën pasdite për ta ftuar sërish personin që të

marrë pjesë në shërbesën e ardhshme të adhurimit apo në ndonjë takim të grupeve të vogla.

4. **Një letër, email apo mesazh nga pastori kryesor.** Një komunikim i tillë personal duhet t'i dërgohet secilit mysafir që ka plotësuar një kartë-koment mirëseardhjeje. Komunikimi duhet të dërgohet nga fillimi i javës mbas vizitës së shërbesës nga personi. Në këtë korrespondencë, pastori duhet të përfshijë informacione rreth kishës dhe një ftesë për të "Klasa e të porsaardhurve", nëse keni një të tillë.
5. **Klasa e të porsaardhurve.** Kjo klasë unike është një përmbledhje prej rreth 45 min ose 1 ore e çdo shërbesë të kishës (klasat e shkollës të së dielës, grupmoshat: të rinjtë, fëmijët, grupet e vogla të studimit, oraret e shërbesës, etj.). Nëse është e mundur, pastori ose drejtues të tjerë të kishës mund të kalojnë nga klasa për të përshëndetur mysafirët, të cilëve mund t'iu shërbehen pije freskuese dhe biskota, si dhe nga një dhuratë e vogël për secilin për t'iu kujtuar vizitën. Statistikat rreth anëtarësimit të kishës ose pjesëmarrjes së rregullt tregojnë se 92 - 98% e personave kanë vazhduar të vijnë në kishë pas kësaj klase.
6. **Dreka e miqësisë për të porsaardhurit.** Çdo muaj mund të zhvillohet një kohë e veçantë miqësie, por jo më pak se një herë në tre muaj. Mundësitë për këtë kohë përfshijnë një vakt me të porsaardhurit e tjerë, pastorin dhe drejtuesit e kishës. Në rast se kjo nuk është e realizueshme, po aq efikase mund të jetë edhe një kafe apo çaj. Ideja është që të ruhet marrëdhënia që ka filluar të zhvillohet. Të porsaardhurit duhet të marrin një ftesë zyrtare të shkruar bashkë me mundësinë për të kthyer përgjigje.
7. **Miqësia e pesë të dielave.** Mbani një takim miqësie të veçantë sa herë që një muaj ka pesë të diela. Kjo është një kohë fantastike miqësie për anëtarët e rregullt të kishës si dhe për t'u njohur më mirë me anëtarët e rinj. Format mund të variojë nga pije freskuese në një vakt për rastet e veçanta.
8. **Projektet e punës së kishës.** Përdorini aftësitë e anëtarëve të ndryshëm në bashkësinë tuaj për projekte pune të kishës. Kjo mund të variojë: nga

pastrimi i ambienteve, tek rinovimi i çerdhes apo i klasave e deri tek një projekt i rëndësishëm rimo-delimi. Njerëzit me interesa dhe aftësi të ndryshme do të investojnë në këtë projekt dhe kështu do të bëhen më të përfshirë në aktivitete të tjera. Po ashtu koha që kalohet së bashku duke punuar është një kohë fantastike për të ndërtuar marrëdhënie.

9. **Skuadra e lutjes së ndërmjetësimit.** Një skuadër lutjeje (anëtarët e së cilës janë caktuar që më parë) duhet të njoftohet kur ka një sëmundje apo vdekje në mesin e familjes së kishës dhe ata duhet të fillojnë menjëherë që të ndërmjetësojnë për personat të cilët kanë nevojë të veçanta në atë moment. Një person mund të caktohet për t'i njoftuar anëtarët e tjerë të skuadrës së lutjes kur të jenë të nevojshëm.
10. **Buletini i "Fytyrave të reja".** Pasi njerëzit të kenë filluar të vijnë rregullisht, merrni leje për t'i vendosur fotografitë e tyre familjare në një buletin të veçantë, i cili i prezanton ata me bashkësinë. Kjo është një mënyrë jokërcënuese që njerëzit të lidhen me familjet, qoftë bashkëshort dhe bashkëshorte, apo prindër me fëmijë.
11. **Jini krijues.** Ekzistojnë shumë mënyra krijuese për të arritur njerëz të rinj ndërkohë që rekrutoni anëtarët e bashkësisë në shërbim të Zotit. Si mendoni për një klasë gatimi për vajzat? Apo, a munden dy çifte nga kisha të ftojnë dy çifte të tjerë që nuk janë ndjekës të Krishtit për një drekë apo darkë? Apo një kamp sportiv për djem? Dhe kështu me radhë, lista e ideve mund të vazhdojë pa fund. Thelbi është që duke i përfshirë njerëzit në shërbesat e kishës, janë duke e bërë prioritet punën e Zotit në jetët e tyre dhe janë duke ndihmuar të tjerët në rrugëtimin e tyre frymëror.

Kërkojini Zotit t'ju drejtojë me një vizion dhe me ide për mënyra efikase për të asimiluar më shumë njerëz në rrethin e miqësisë dhe të marrëdhënieve në vendin tuaj apo në kulturën tuaj. Ndërkohë që shërbesa e mikpritjes merr një dimension të ri, kisha do të forcohet dhe rritja do të fillojë që të ndodhë në nivele të reja. Nuk do të kalojë shumë dhe ju do të reflektoni mbi gjërat e mrekullueshme që Zoti ka bërë. Dhe padyshim që do të thoni se ishit duke u rritur, atëherë kur askush nuk po ju shihte.



MARCIA LEDNICKY, është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj të jashtëzakonshëm vokal përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.

Menaxhimi i Konfliktit në Kishat më të Vogla

Nga: JAMES D. WILKINS

Dje, disa njerëz të bashkësisë suaj ju privuan nga gëzimi, paqja dhe nga disa prej orëve tuaja më produktive. Mbrëmë ata ju vodhën gjumin. Sot ndiheni i trishtuar dhe i lodhur. Është e vërtetë që këta njerëz nga bashkësia juaj janë nevojtarë, të vështirë në komunikim dhe ndonjëherë janë në konflikt me ju apo me njerëz të tjerë nga kisha. E megjithatë, ata janë njerëzit që doni. Ata janë njerëzit që Perëndia ju ka thirrur që t'i ndërtoni, t'i forconi dhe që t'i sillni në atë pikë që të kryejnë punën e shërbesës.

Ky artikull do t'ju ndihmojë të gjeni mënyra për të lehtësuar dhimbjen e konfliktit dhe për të prodhuar shëndet të mirë në jetën dhe në bashkësinë tuaj.

MENAXHIMI I KONFLIKTIT


Konflikti prodhon stres, dhe stresi prodhon një ndikim rrënues derisa të gjeni një mënyrë për ta zgjidhur atë. Disa pastorë e përdorin gabimisht katedrën si një mundësi për të korrigjuar njerëzit që janë në konflikt. Por ekziston një mënyrë më e mirë për të lehtësuar dhimbjen e konfliktit dhe për të prodhuar shëndet të mirë për familjen e Perëndisë. Malakia 2:16 ju këshillon që të tregoni kujdes për frymën tuaj në mënyrë që të mos veproni me pabesi. Gjendja mendore e pastorit mund të ketë efekte të fuqishme. Në një situatë konflikti, mund të jeni ose i frytshëm ose i dëmshëm.

Në cilësinë e pastorit, teologjia që keni për konfliktin do të përcaktojë mënyrën se si do të përballeni me të. Në rast se e kuptoni që konflikti ndërpersonal nuk është gjithmonë i keq, atëherë mund të pushoni mirë gjatë natës dhe kjo gjë do t'ju lejojë që ta menaxhoni konfliktin në mënyrë më krijuese. Në qoftë se të gjithë konfliktin e shikoni si mëkat, atëherë do të keni vështirësi për t'i ndihmuar njerëzit përmes situatave të konfliktit. Shembulli që na jepet tek Veprat e Apostujve 15 tregon se konflikti mund të ndihmojë që të qartësohen disa çështje dhe të zbulohet vullneti i Perëndisë. Këshilli i Jerusalemit sqaroi një çështje doktrinale dhe i hapi rrugën një segmenti të tërë të popullsisë për t'u bërë pjesë e trupit të Krishtit.

Një pastor i mirë nuk e kërkon konfliktin, por as nuk arratiset prej tij dhe as nuk lejon që të terrorizohet prej tij dhe t'i vidhet integriteti dhe mirëqenia emocionale. Ekzistojnë dy motivime të shëndosha për t'i dhënë vëmendje të veçantë menaxhimit të konfliktit në bashkësitë më të vogla: mirëqenia e kishës dhe shëndeti juaj emocional si pastor.

Menaxhimi krijues i konfliktit në kishën e vogël shpeshherë mund të jetë një sfidë e vërtetë. Kishat më të vogla, në shumicën e rasteve, përbëhen nga disa njësi familjesh të vogla ose nga një familje e madhe e cila ka qenë pjesë e bashkësisë për shumë vite. Këto familje ndonjëherë supozojnë se dëshirat e tyre duhet të konsiderohen si më të rëndësishme sesa dëshirat e të tjerëve që nuk kanë qenë në kishë për një kohë aq të gjatë sa ata apo që nuk kanë aq shumë anëtarë të familjes të prani-shëm sa ata. Kur kjo gjë ndodh, konflikti kthehet në mundësi reale. Dhe kur konflikti zhvillohet, shpeshherë nuk arrijnë ta kuptojnë se ishin pikërisht ata shkak i konfliktit. Në mendjen e tyre, ata janë shtyllat e kishës dhe dinë çfarë është më e mira për kishën. Madje ata mund t'i referohen kishës si një familje dhe t'ju thonë se janë të lumtur që ju kanë juve si pastor apo si një anëtar të familjes. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rast se jeni i ri në atë kishë.

Pastorët e bashkësive më të vogla duhet të jenë të vetëdijshëm se menaxhimi i konfliktit është pjesë e të qenit pastor, dhe mënyra më e mirë për t'u marrë



**KONFLIKTI PRODHON STRES, DHE STRESI
PRODHON NJË NDIKIM RRËNUES DERISA TË
GJENI NJË MËNYRË PËR TA ZGJIDHUR ATË.**

me konfliktin është duke kërkuar zgjidhje në stadtet më të hershme të tij. Ndjenjat e tensionit në kishë janë një shenjë se mund të jetë duke u gatuar ndonjë konflikt. Dhe kjo është pikërisht koha kur duhet të filloni të përballeni me çështjen. Fatkeqësisht, problemi shpesh përparon përmes fazave të ndryshme derisa të ndodhë një ballafaqim i detyruar. Në kishën e Dhjatës së Re, udhëheqësit i sollën para njëri-tjetrit palët që kishin mosmarrëveshje. Ata punuan për ta zgjidhur problemin derisa arritën në një zgjidhje. Kështu duhet të bëni edhe ju.

STILET E MENAXHIMIT TË KONFLIKTIT

Si pastor, duhet të përzgjidhni stilin më të mirë të menaxhimit të konfliktit për një situatë të caktuar. Një nga gabimet më të rënda që mund të bëni është që të zgjidhni stilin e gabuar për një rrethanë të caktuar. Shpeshherë pastorët kanë një stil të preferuar për t'u përballur me konfliktin, si edhe një stil rezervë. Ju mund të mësoni që të zgjidhni me vetëdije stilin më të mirë për të përmbushur nevojën që ju paraqitet. Krahasojini teknikat tuaja të menaxhimit me këto përshkrime.

Stili i shmangies

Personi që ka këtë stil preferon të besojë se nuk ka konflikt. Në qoftë se i duhet të pranojë se ekziston një problem, përgjithësisht ai ka këtë qëndrim: "Nuk ma ka qejfi që të përfshihem". Ai shpreson se konflikti do të largohet pa ndërhyrjen e tij. Ai është më i interesuar për të mbrojtur veten e tij, sesa për të gjetur një zgjidhje.

Njerëzit që përdorin këtë stil detyrojnë dikë tjetër që të marrë përgjegjësinë për zgjidhjen e konfliktit. Në disa raste, është e lejueshme që të përdoret stili i shmangies. Për shembull, mund të ketë raste kur çështja është kaq e parëndësishme saqë nuk ia vlen t'i kushtoni vëmendje. Megjithatë, nëse e përdorni rregullisht këtë stil, shumë shpejt njerëzit do t'ju shohin si dikush i cili nuk është i përshtatshëm për të udhëhequr. Pala kundërshtuese do ta mbërthejë këtë mundësi për të ndërtuar një burim ndikimi apo autoriteti. Sjellja acaruese apo armiqësore do të vazhdojë të rritet derisa të mos mundeni ta anashkaloni më problemin.

Stili i harmonizimit

Ai që kërkon të harmonizojë shpeshherë është një paqedashës. Motoja e tij është: Marrëdhëniet janë më të rëndësishme sesa problemet. Ai e shpenzon kohën duke u përpjekur që të përçojë këtë mesazh pa e trajtuar çështjen që përçan njerëzit. Ekzistojnë disa raste kur ky stil mund të përdoret me efikasitet, por jo në të gjitha rastet. Pastori që përdor vazhdimisht këtë metodë, në fund do të konsumohet sepse problemi që shkakton përçarjen nuk gjen asnjëherë zgjidhje. Të tjerët që janë të përfshirë në një konflikt

të stërzgatur bëhen më kërkuar dhe më agresivë. Pastori përjeton më shumë stres sepse është jashtë-zakonisht e rëndë dhe e lodhshme që të buzë-qeshësh gjatë gjithë kohës kur nga brenda dëshiron të qash. Në rast se kjo vazhdon për disa muaj apo vite me radhë, pastori mund të japë dorëheqjen dhe të shkojë diku tjetër, ku gjithsesi vetëm sa do të përsërisë ciklin.

Stili i negocimit

Pastori që përdor këtë teknikë përpiqet t'i bindë të gjithë që të heqin dorë nga diçka me qëllim që secila palë të fitojë një pjesë të asaj që duan. Ushtrimi i presionit ndërkohë që kërkohet një kompromis mund të ndihmojë për të sjellë në jetë një zgjidhje. Rezultatet e kësaj lloj përpjekjeje shpesh janë pozitive. Personi që ka këtë stil është bindës, por ndonjëherë në një mënyrë të hollë e fine. Problemi me këtë metodë është që zgjidhja më e mirë mund të flijohet për të përfutur një zgjidhje më pak të përsosur. Kjo teknikë nuk mund të jetë idealja, por është më mirë sesa alternativa tjetër pa asnjë zgjidhje. Një rast i mirë për ta përdorur këtë stil është kur sulmi nga palët ndërluftuese mund ta përçajë kishën përpara se të ketë një mundësi për të arritur në një zgjidhje të përsosur dhe të kënaqshme për të dyja palët. Rreziku i kësaj është që njerëzit që janë në konflikt mund të mos e besojnë me gjithë zemër vendimin që merret. Njerëzit duhet të ndihen sikur janë ata pronarë të zgjidhjes, përndryshe do ta kenë përkushtimin me gjysmë zemre ndaj asaj zgjidhjeje.

Kombinimi i stileve të harmonizimit dhe të negocimit funksionoi për mrekulli për pastorin e një kishe më të vogël familjare. Bashkësia ishte e përbërë nga dy vëllezër dhe familjet e tyre të mëdha, si dhe një segment i tretë i anëtarëve të vjetër, por që nuk ishin pjesë e familjeve. Shpesh, në bashkësi krijoheshin disa probleme, madje edhe mes familjeve të mëdha. Mbajtja e ofiqit të pastorëve ishte për periudha të shkurtra kohe. Njëri nga anëtarët e familjes ishte bërë predikues, dhe bashkësia vendosi se zgjidhja për problemin e tyre do të ishte që ta lejonin atë të bëhej pastor i kishës ku ishte rritur. Kjo funksionoi deri në momentin kur ai dhe xhaxhai i tij filluan t'i shohin gjërat nga perspektiva të ndryshme. Zgjidhja e përsëritur shpesh ishte që të merrnin përsëri një shërbëtar të ri. Eventualisht një pastor i butë, por i pjekur, erdhi dhe qëndroi për shumë vite. Ai i shpalsi vazhdimisht frytet e Frymës dhe filloi t'i mësonte anëtarët që kishin konflikte që të hiqnin dorë nga disa prej të drejtave të tyre për hir të harmonisë. Paqja filloi të mbretërojë dhe bashkësia u rrit dhe përparoi.

Stili i frikësimit

Ky stil krijon një atmosferë ku të tjerët ndihen aq të shkurajuar sa nuk arrijnë të ndajnë informacione të

rëndësishme dhe faktike. Megjithatë, ky informacion është pikërisht ai që mund të sigurojë përgjigjet për problemin. Pastori që përdor këtë metodë ka shpeshherë një agjendë personale dhe e paracakton se cilën palë dëshiron ta shohë si fituese. Një pastor tregon se në vitet e tij të para të shërbesës, ai hynte në çdo konflikt për të fituar. Madje edhe atëherë kur tërhiqej apo dorëzohej, kjo bëhej që në përfundim të dilte ai fitimtar. Kurdoherë që një pastor e sheh konfliktin si një situatë ku gjithmonë duhet të ketë një fitues dhe një humbës, atëherë eventualisht ai do të jetë një prej humbësve. Në mënyrë të paqëllimshme, ai do t'u ketë mësuar armiqve të tij dhe personave grindavecë në bashkësi se mënyra për të fituar është duke grumbulluar fuqi, dhe ata do të kërkojnë të bëjnë të njëjtën gjë.

Ka raste kur marrja e një vendimi individual dhe të vështirë është e vetmja mënyrë e duhur, por kjo gjë duhet bërë me një masë të caktuar. Qëndrimet e shpeshta për t'i zgjidhur konfliktet me një frymë autoritare do të rezultojnë në një bashkësi të lëkundur. Do të vijë dita kur aty do të ngelen vetëm një grusht njerëzish. Disa prej atyre që janë lënë pas do të mbushen me indinjatë të thellë sepse ndihen sikur askush nuk u kujdes ndonjëherë për opinionet e tyre.

Stili i rrjetëzimit

Ndoshta mënyra më efikase për t'u marrë me konfliktin në mënyrë të rregullt është përmes rrjetëzimit. Pastori ose ndihmësi, duke përdorur këtë metodë, do të kërkojë t'i përfshijë individët kundërshtarë apo grupet e familjeve që ta përcaktojnë problemin, të sugjerojnë zgjidhje dhe të bien dakord për hapat që duhen marrë për të vënë në zbatim zgjidhjen. Pastorit mund t'i duhet të bëjë vajtje-ardhje nga një grup apo individ tek tjetri përpara se t'i sjellë përpara njëri-tjetrit për të vendosur për një zgjidhje. Njerëzit kanë tendencën që ta mbështesin diçka të cilën ata kanë ndihmuar që të krijohej. Kjo është ajo që bëjnë familjet. Objektivi është t'i ndihmojmë njerëzit që të ballafaqojnë çështjet, në vend që të ballafaqojnë njëri-tjetrin në përpjekje për të zgjidhur konfliktin. Kjo kërkon pak kohë, por ia vlen barra qiranë.

Dy nga objektivat themelore të stilit të rrjetëzimit janë përmbushja e qëllimeve të njerëzve që janë të përfshirë dhe ndreqja ose mirëmbajtja e mirëqenies së bashkësisë. Në qoftë se këto objektiva nuk arrihen në një kishë të vogël, atëherë si rrjedhojë, ajo do të bëhet një kishë edhe më e vogël. Në disa situata, pastorët zgjedhin rrugën më të lehtë dhe lënë bordin e kishës që t'i marrë të gjitha vendimet e vështira. Megjithatë, kjo gjë i rrëzon dy objektivat që sapo përmendëm. Sistemi i rrjetëzimit do të humbasë në interes të marrjes së një vendimi, dhe papritur, njëra palë bëhet fituese dhe pala tjetër, humbëse.

Rrjetëzimi kërkon një kombinim unik të aftësive që përfshijnë durim, këmbëngulje dhe fleksibilitet. Të gjithë duhet ta ndjejnë që pastori beson se qëllimet e tyre janë të rëndësishme, por ai duhet të ngulmojë tek faktet dhe të bëjë dallimin midis fakteve dhe opinionëve. Ai krijon një atmosferë e cila shpall: "Në qoftë se punojmë së bashku, do të gjejmë qasje ndaj problemit të konfliktit, të cilat do të jenë të pranueshme për të dyja palët". Të gjithë do të kenë njëfarë mundësie për të qenë fitues, sepse të dyja palët kundërshtare po bien dakord për zgjidhjen; dhe, çfarëdo që të humbasin, ata po e dorëzojnë me zgjedhjen e tyre. Stili i rrjetëzimit është më i miri për shumicën e situatave, por që një pastor ta përdorë këtë metodë i duhet të ketë ca kohë nëpër duar. Kur koha është e kufizuar, atëherë zgjidhja mund të shtrihet në gjetjen e kompromiseve apo dhënien e lëshimeve.

PËRMBYLLJA

Siç e thamë edhe më lart, shumica e pastorëve kanë një stil të preferuar për menaxhimin e konfliktit, si edhe një stil rezervë. Për të përcaktuar stilin tuaj rezervë, vëzhgoni se te cili stil shkoni menjëherë sapo viheni nën presion. Kur progresi është i ngadaltë, tundimi është që të braktiset metoda e përzgjedhur dhe të favorizohet ajo që është rezervë. Pastori që është i urtë përzgjedh me vetëdije atë stil që është i duhuri për situatën dhe shkon tek një stil tjetër vetëm atëherë kur nuk po bëhet asnjë progres.

Aspekti i fuqishëm i lutjes duhet gjithashtu që të jetë vazhdimisht i gërshetuar me të gjitha procedurat e menaxhimit të konfliktit. Lutja është më e fuqishme sesa të gjitha aftësitë e menaxhimit të marra së bashku. Lutja, jo vetëm që do ta fuqizojë dhe do ta ndihmojë drejtuesin që të shkojë përpara me një qëndrim pozitiv në lidhje me menaxhimin e konfliktit në kishë, por gjithashtu do ta aftësojë ndërmjetësin që të përcaktojë se kush duhet të jetë rezultati përfundimtar.

Pastorët e urtë e pranojnë se të krishterët nuk kanë nevojë që të shkatërrojnë kishën dhe njëri-tjetrin. Ata gjejnë mënyra për të menaxhuar konfliktin. Ata përdorin fuqinë e lutjes bashkë me aftësitë e dhëna nga Perëndia për ta përmbushur atë.



JAMES D. WILKINS është ish menaxher i qarkut të Nebraskës. Ai është themeluesi i shërbesës Assist, Inc., e cila është një shërbesë e dedikuar për të ndihmuar pastorët që shërbejnë në kishat e vogla.

*Thirrja e pastorit
që ka dy
profesione është
njësoj e vlefshme
sa edhe thirrja e
një pastori që
është në shërbesë
me kohë të plotë.*



SHËRBESA ME DY PROFESIONE

**Strategji Legjitime apo një
E Keqe e Domosdoshme?**

Nga: **CHRIS RAINEY**

*Një punë laike
ofron mundësi për
të takuar njerëz të
cilët përndryshe
nuk do të dëgjonin
asnjëherë për
kishën.*

SHËRBESA ME DY PROFESIONE

Pastorët me dy profesione kanë të paktën dy punë dhe zakonisht punojnë 30-40 orë në javë në një punë laike dhe 25-30 orë në javë në kishë. Me këtë lloj orari, pastorët me dy profesione e kanë të vështirë të gjejnë ekuilibrin delikat mes nevojave personale, familjare dhe atyre të kishës, si dhe kërkesave të punës laike. Ata mund ta kenë të vështirë që të marrin pjesë në takime miqësie specifiku për pastorët apo nëpër takime të tjera, gjë e cila shpesh rezulton në izolimin e tyre. Disa pastorë me dy profesione e perceptojnë vetveten si inferiorë për shkak se nuk janë në shërbesë me kohë të plotë. E megjithatë, si pastorë me dy profesione, ju iu ofroni një shërbesë të vyer kishave më të vogla të cilat nuk e përballojnë dot koston e rrogës së një pastori.

NJË MODEL BIBLIK PËR SHËRBESËN ME DY PROFESIONE

Pastorët me dy profesione është mirë që të kuptojnë modelin biblik për shërbesën me dy profesione. Në kohën që fillova shërbesën time me dy profesione, nuk isha i vetëdijshëm se isha duke ndjekur një strategji për shërbesën me dy profesione që ishte e ngjashme me atë që apostulli Pal kishte përdorur për gati një vit e gjysmë në Korint (1 Korintasve 9:7-15), për tri vite në Efes (Veprat e Apostujve 20:32-35), dhe për njëfarë kohe në Selanik (1 Thesalonikasve 2:9). Profesionin e tij ishte tenda-punues, një term ky që për shërbestarët modernë ka marrë kuptimin e dy profesioneve.

Në Korint, Pali iu mësoi besimtarëve se një predikues e ka të drejtën që ta fitojë bukën e gojës nga ungjilli. Megjithatë, ai refuzoi që ta ushtronte këtë të drejtë në Korint për hir të ungjillit (Veprat 18:1-11). Kjo e lejoi atë që të predikonte ungjillin (1 Kor. 9:18) dhe të mos ishte një barrë financiare për kishën (2 Kor. 11:9). Pali gjithashtu e përshkroi marrëdhënien e tij me korintasit me fjalët e një prindi i cili ishte plotësisht i gatshëm që të shpenzonte me gëzim dhe të shpenzohej krejt për shpirtrat e tyre (2 Kor. 12:15). Ky qëndrim flijues qëndron në zemër të një shërbestari me dy profesione. Një pastor me dy profesione, duke mos pasur të ardhura ose duke pasur të ardhura të kufizuara, punon si rrjedhojë e dashurisë sakrifikuese.

Në Efes, përmes shërbesës me dy profesione, Pali vuri në praktikë në jetën e tij fjalët e Jezusit: "Më lum është të japësh sesa të marrësh!". Pali u kujdes vetë për nevojat e tij, në mënyrë që t'u shërbente atyre që ishin më të dobët në mesin e tyre (Veprat e Apostujve 20:32-35).

Në përgjithësi, Pali duhet ta ketë konsideruar zanatin e tendapunuesit si pjesë të sigurimit të Perëndisë (Fil. 4:11-13). Për Palin, të shërbeje në një shërbesë besimi nuk ishte në kundërshtim me një strategji të shërbesës me dy profesione. Megjithatë Pali e kuptonte parimin e përgjithshëm, pra, një shërbestar duhet ta fitojë bukën e gojës nga ungjilli, ai e refuzonte me vullnet të plotë mbështetjen në disa situata.

AVANTAZHET E SHËRBESËS ME DY PROFESIONE

Ndonjëherë pastorët me dy profesione shkurajohen për shkak se nuk mund t'i kushtojnë më shumë kohë shërbesës në kishën e tyre. Por ndonjëherë është e dobishme që të shohim aspektet pozitive të shërbesës me dy profesione.

Sigurimi financiar në një kishë të vogël.

Shërbesa me dy profesione i lejon pastorët të sigurojnë për familjet e tyre në ato situata ku financat e kishës janë të kufizuara. Pastori është në gjendje që të sigurojë të ardhura të përshtatshme, dhe kisha vazhdon të shpallë ungjillin në komunitet. Thirrja e pastorit me dy profesione është po aq e vlefshme sa edhe thirrja e pastorit që është në shërbesë me kohë të plotë.

Një devijim i mirëpritur midis punës laike dhe shërbesës në kishë.

Në disa raste, pastorët mund ta preferojnë shërbesën me dy profesione. Ata mund të kenë një mjeshtëri të caktuar në një fushë të caktuar të cilën iu pëlqen ta bëjnë edhe atëherë kur nuk kanë shtrëngime të tjera për të punuar jashtë shërbesës. Koha e shpenzuar në një punë laike e ndihmon pastorin që të ruajë një perspektivë të shëndetshme në secilën fushë të jetës.

Mundësi për ungjillëzim dhe për shërbesë personale.

Disa pastorë kanë kontakte të kufizuara me persona jo të krishterë. Një punë laike ofron mundësi për të takuar njerëz të cilët përndryshe nuk do të mësonin kurrë rreth kishës. Pastorët me dy profesione, bashkë me një punë laike, mund të modelojnë gjithashtu ungjillëzimin si stil jetese për bashkësitë e tyre.

Një perspektivë ndryshe nga ajo e shërbesës.

Pastorët me dy profesione mund ta shohin jetën në komunitet nga një perspektivë jo prej shërbestari. Kjo mund të jetë e përshtatshme në predikim. Një punë laike i tregon shërbestarit gjendjen e vërtetë të komunitetit dhe nevojat më emergjente aty. Duke adaptuar ilustrime nga mjedisi i punës laike në predikimet e tyre, pastorët me dy profesione mund t'i u mësojnë bashkësive të tyre se si të vënë besimin e tyre në zbatim nëpërmjet situatave nga jeta reale.

DISAVANTAZHET E SHËRBESËS ME DY PROFESIONE

Kufizimet kohore.

Shërbesa me dy profesione e kufizon sasinë e kohës që pastorët mund të shpenzojnë për përgatitjen e predikimit, administrimin e kishës, vizitat, përgjegjësitë familjare, pushimin dhe kohën e lirë. Për shkak të kufizimeve kohore, pastorët me dy profesione zakonisht kanë kohë të mjaftueshme sa për të bërë minimumin e volumit të punës për të mbijetuar, dhe si rezultat i kësaj, kishat e tyre mund të vuajnë.

Pastorët me dy profesione gjithashtu do të kenë nevojë t'i vendosin prioritetet kohës së tyre në mënyrë që të mos e përdorin atë në një mënyrë të pamatur. Megjithatë kisha mund të jetë e vogël, pastorët me dy profesione mund t'ia delegojnë disa prej përgjegjësisë të tyre anëtarëve të kishës. Ia vlen barra qiranë që të trajnojmë udhëheqës vullnetarë. Ndërtimi i një skuadre për shërbesë, edhe nëse është vetëm me një apo dy persona të tjerë, ndihmon për ta lehtësuar paksa barrën e pastorit dhe iu mëson anëtarëve se çdo person ka një pjesë të caktuar në ndërtimin e trupit të Krishtit.

Shqetësimet e punësimit laik.

Shpeshherë shërbestari ka aftësi të kufizuara punësimi, që e bëjnë punën shtesë të mos jetë shpërblyese. Nga ana tjetër, disa shërbestarë gjejnë punë laike shumë shpërblyese, të cilat u sigurojnë kompensime dhe përfitime të mira. Situata e dytë do ta vinte në goxha provë përkushtimin e shërbestarit ndaj thirrjes për të qenë pastor. Duke qenë se i kam provuar të dyja llojet e punëve ndërkohë që isha edhe pastor, unë do të rekomandoja të gjenit një profesion që ofron fleksibilitet të mjaftueshëm për të kryer thirrjen tuaj për shërbesë si dhe për të qenë të disponueshëm për urgjencat në kishë.

Kërkesa të larta për bashkëshorten dhe familjen.

Për shkak se shpeshherë pastorët me dy profesione nuk janë të disponueshëm, bashkëshortet e tyre mund të përfundojnë duke marrë mbi vete më tepër përgjegjësi për kishën se ç'duhet. Gruaja ime, si amvisë, dhe duke pasur zyrën e kishës në shtëpinë tonë, iu përgjigjej shumicës së telefonatave të kishës dhe përpiquej t'iu gjente zgjidhje situatave problematike kur unë nuk isha i disponueshëm. Gjithashtu edhe detyrat administrative i binin asaj si barrë. Në fillim, asaj i pëlqeu të merrte pjesë në këtë mënyrë në shërbesë, por me kalimin e kohës, filloi ta kishte zët mënyrën se si njerëzit shihnin atë si kontaktin parësor për kishën. Dhe eventualisht ajo i drejtoi besimtarët tek unë, edhe atëherë kur unë nuk isha menjëherë i disponueshëm.

Por edhe me kufizimet kohore, pastorët me dy profesione duhet të caktojnë kohë me bashkëshorten

dhe familjen e tyre. Ndërkohë që nevojat e ngutshme të shërbesës mund të kërkojnë vëmendjen e tij, koha që shpenzohet me familjen është një prioritet në jetën e pastorit me dy profesione.

Perceptimi i klerit të dorës së dytë.

Për shkak se shërbestarët me dy profesione shpeshherë nuk mund të ndjekin aktivitetet miqësore që organizohen për pastorë, ata mund të ndihen si qytetarë të dorës së dytë në komunitetin e klerit. Por gjithsesi, shërbestarët me dy profesione duhet të gjejnë kohë për këtë miqësi shumë të nevojshme dhe të krijojnë një ndërgjegjësim të pranishëm dhe të shërbesës së tyre.

Duke rënë në kontakt me shërbestarët që janë në zonën tuaj, ata do të jenë të vetëdijshëm për nevojat tuaja. Ndoshta disa pastorë kanë kaluar përmes situatës ku jeni ju tani. Këshilla e tyre e urtë mund t'ju ndihmojë gjatë kësaj kohe në shërbesën tuaj. Pasi ta keni bërë këtë përpjekje, do të habiteni se si i hap dyert Perëndia për miqësi me pastorë të tjerë.

STRATEGJI TË ARSYESHME PËR SHËRBESAT ME DY PROFESIONE

Megjithatë Pali e quan të vlefshme shërbesën me dy profesione, ai e përdori këtë model për përpjekjet e kishëmbjelljes. Edhe ne do të bënim mirë të merrnim në konsideratë një model të ngjashëm për përpjekjet bashkëkohore të kishëmbjelljes.

Përveç kishëmbjelljes, janë edhe disa situata të tjera të cilat janë me vend për shërbesën me dy profesione. Për shembull, shërbesa me dy profesione mund të jetë një zgjedhje goxha e përshtatshme për kishat që janë në rënie, kishat që janë në zona të zymta nga ana ekonomike ose për një anëtar stafi në një kishë në rritje e cila po përjeton rizgjim. Shërbesa me dy profesione nuk duhet të shihet si vartëse e shërbesës "me kohë të plotë", duke qenë se ka shumë situata në të cilat një pastor me dy profesione është zgjidhja e duhur për të kryer një shërbesë.

Një pastor i cili është plotësisht i mbështetur financiarisht nga kisha vendore mbetet norma dhe ideali i Dhjatës së Re. Megjithatë, shërbesa me dy profesione mund ta përparojë punën e Mbretërisë në disa situata të përshtatshme. Në ato raste, kjo duhet të shihet si një strategji e arsyeshme e shërbesës.



CHRIS RAINEY ka shërbyer si kishëmbjellës me dy profesione për 7 vjet dhe aktualisht punon si ndihmës pastor me dy profesione në Asamblenë e Perëndisë në qytetin Engëllud të Nju Xhersit.

"Ai foli, dhe gjëja u bë." Psalmi 33:9

Nga: **FATJON KADIU**

Në këto 3 - 4 muajt e fundit jemi duke parë një derë të hapur nga Zoti si asnjëherë më përpara në këto 8 vite që jemi aty. Jemi duke parë fuqinë e ungjillit të transformojë realisht jetë njerëzish.

Në vjeshtën e vitit 2017, Fryma e Shenjtë na dha një fjalë profetike për kishën, nga profeti Isaia 56:7-8: "Unë do të afrojmë shumë të tjerë". Në një nga shërbesat e së dielës, një vajosje profetike zbriti mbi kishën, e cila u përfshi në adhurim dhe aty pata një vizion për kishën. Ishte duke vështuar dhe ja salla ishte e mbushur plot e përplot me njerëz që ishin duke adhuruar Atin dhe duke dëgjuar Fjalën me uri. E ndava këtë vizion me kishën dhe një fjalë profetike që nëse kisha do të ishte besnike për t'iu përkushtuar lutjes, **Zoti do të afronte shumë njerëz të tjerë**. Së bashku me bashkëpunëtorët, filluam të kërkonim Zotin e të intensifikonim lutjet. Të gjithë ne ishim të bindur se Fryma e Shenjtë na kishte folur qartë dhe shumë shpejt pamë se si Ai po përmbushte atë që na kishte premtuar.

Që nga periudha e Krishtlindjes, ne filluam të ndjenim dhe përjetonim një liri më të madhe frymërore, një vajosje dhe prani më të prekshme të Frymës, si edhe zemra pranuese ndaj Fjalës si rrallëherë më parë. Njerëz të rinj filluan që të vinin në shërbesa dhe riktheheshin duke sjellë edhe të tjerë. Pjesëmarrja në shërbesa pothuajse është dyfishuar. Anëtarët më të vjetër të kishës janë të inkurajuar e rifreskuar nga ajo që po shohin se po bën Zoti. Kjo i ka motivuar që të përfshihen më shumë në shërbesa. Gjatë këtyre muajve të fundit që prej Krishtlindjes, ka pasur rreth 35-40 vizitorë të rritur për herë të parë, nga të cilët rreth 25 kanë pranuar Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar, si dhe një numër shumë i madh fëmijësh.

Jemi shumë të inkurajuar të dëgjojmë dëshmi nga burra dhe gra të shpëtuar së fundmi, se si ata kanë gjetur paqe, çlirim, shpresë e siguri tek Krishti. Jemi të inkurajuar, sepse kjo vepër e Zotit ka prekur edhe dy prej kishë-mbjelljeve tona në Baltëz dhe Drizë, ku ndjejmë një liri më të madhe për Ungjillin dhe ku në të dyja ka një pjesëmarrje të shtuar në shërbesa dhe njerëz që kanë uri për të njohur Krishtin.

Ne besojmë se ky është vetëm fillimi. Dimë (prej dëshmisë së brendshme të Frymës) se ka shumë më tepër përpara. Dhe kjo na motivon që të jemi edhe më tepër besnikë në veprën e Zotit. Është lutja jonë që Zoti Jezus, emri i cilit është Besniku dhe Amen, të vazhdojë të shtrijë dorën e Tij për të shpëtuar, çliruar dhe shëruar jo vetëm mbi Fierin, por mbi të gjithë kombin tonë.

FATJON KADIU, pastor,
Kisha Lajmi i Mirë, Fier.



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

KTU përgatit pastorë, misionarë dhe shërbestarë nëpërmjet përgatitjes biblike për të shpallur ungjillin dhe për të ndërtuar kishën me Fuqinë e Frymës së Shenjtë.

Pastor, nëse keni nevojë të zhvilloni bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në kishën tuaj, lejoni që KTU të ndihmojë!

Në KTU, studentët do të mësojnë rëndësinë e formimit transformues të karakterit, të jetës së krishterë në komunitet, doktrinës së shëndoshë, mësimi të mirë biblik, teologjik, misiologjik, si dhe përgatitjes së balancuar dhe serioze për shërbesë. Dërgimi i një studenti në KTU kërkon besim, përkushtim dhe sakrificë, por ju garantojmë që ia vlen të investosh.

Për më shumë informacion:

Email: ktu@icc-al.org

Cel.: 069 406 8956



KONFERENCA E TE RINJVE V

MISION PER BALLKANIN

Foles:
Ian Derek Williams



“Dhe ky ungjill i mbretërisë do të predikohet në të gjithë botën si një dëshmi për të gjithë kombet, dhe atëherë do vijë mbarimi.” Mateu 24:14

Në datat: 1- 3 qershor 2018; Tek Hotel Bonita, Durrës

**Për t'u regjistruar apo për më shumë informacion,
kontaktoni: Pastor Gëzim Spahija, Cel.:069 405 5023**